

KORI TEN BUM



KORI TEN BUM

Teksti: Barbera Nooitgedagt
ilustruar nga: Suzanne Peavy
Përktheu: Ornela Shuqja
Redaktoi: Irena Sema

JU LUTEMI VINI RE!

Vizualet për këtë seri mund të blihen në pjesën më të madhe të zyrave të BUF-it dhe në dyqanet në internet. Për një listë të zyrave të BUF-it dhe dyqaneve në internet në Evropë, ju lutemi vizitoni www.teachkids.eu/al dhe kliko mbi “Vendet”.

Text published by: European CEF®
Kilchzimmer
4438 Langenbruck
Switzerland
www.cefeurope.com



Copyright © 2008 Child Evangelism Fellowship® of Europe
Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përdorur me leje.
Mund të riprodhohet vetëm për përdorim personal, shërbese,
jofitimprurës ose jo-komercial. Vizitoni www.teachkids.eu/al
për më shumë detaje mbi lejen e përdorimit.

Pasqyra e lëndë

Mësimi		Faqe
Hyrje		3
Mësimi 1	Bariu i Mirë	5
Mësimi 2	Një familje e lumtur	11
Mësimi 3	Në shkollën e Perëndisë	17
Mësimi 4	Jezusi është Fitimtar	23
Mësimi 5	Një endacake për Zotin	31
Përmbledhje e hapave për këshillimin e fëmijës që dëshiron të vijë tek Krishti		38

Hyrje

Në njërin nga librat e saj Kori Ten Bum tregon se si ajo dhe një mike e saj misionare po udhëtonin nëpër një zonë shumë të varfër të Koresë. Papritur ato dëgjuan fjalët e një himni të njohur. Ato ndaluan makinën dhe dëgjuan. Një grua koreane po këndonte. Gruaja koreane po këndonte, “Atje ku është Jezusi, është Qielli.” Ajo kishte shumë pak nga të mirat që kjo botë ka por Shpëtimtari i saj, Zoti Jezus Krisht, ishte me të dhe kjo sillte ndryshimin.

Prania e Zotit solli të gjithë ndryshimin në jetën e Korit gjithashtu...

- ◆ ndërsa u rrit në Hollandë;
- ◆ kur filloi të shërbente në Londër në Haarlem;
- ◆ kur u burgos në Ravensbrück;
- ◆ ndërsa udhëtonte në të gjithë botën në Shërbim të Zotit.

Lutja jonë është që nëpërmjet këtij mësimi, djem dhe vajza të njohin Zotin dhe të përjetojnë bekimin e pranisë së Tij me ta çdo ditë. Lumturia e vërtetë nuk varet nga rrethanat, por nga marrëdhënia jonë personale me Zotin Jezus Krisht. Zoti i premton të gjithë atyre që besojnë në Të: “Nuk do të të lë, nuk do të të braktis” (Hebrenjve 13:5).

Burimi i materialit

“The hiding place” “*Vendi i fshehtë*” - nga Kori Ten Boom me John and Elizabeth Sherrill, publikuar nga Fleming H. Revell Company

“Tramp for the Lord” “*Endacake për Zotin*” - nga Kori Ten Boom me Jamie Buckingham, publikuar nga Christian Literature Crusade

“Marching orders for the end battle” “*Urdhëra për betejën e fundit*” - nga Kori Ten Boom, publikuar nga Christian Literature Crusade

“Not good if detached” “*Jo mirë i veçuar*” - nga Kori Ten Boom, publikuar nga Christian Literature Crusade

“The five silent years” “*Pesë vitet e qeta*” - nga Pam Rosewell, publikuar nga Zondervan

Datat e rëndësishme në jetën e Kori Ten Bum

1892	Lindi në Haarlem, Holland
1897	U shpëtua në moshën pesë vjeçe
1921	Vdes nëna e Korit
1926-40	Punoi me klubet e vajzave
1940	Ushtria gjermane pushton Hollandën
1942	Fillimi i “Nëntoka e Perëndisë”
1944	Burgoset; vdes babai i Korit, pastaj motra e saj Betsi
1945	Çlirimi i Hollandës
1949	Kori fillon të udhëtojë për Zotin
1983	Kori vdes në ditëlindjen e saj të 91-të (Prill 15)

Praktikim për përdorimin e vizualeve

Është me mend që të praktikoni përdorimin e vizualeve para se t'u jepni mësim fëmijëve. Mësohuni me flashkard (figurat) ose slajdet e PowerPoint që ta dini se kur do t'i përdorni në mësim.

Përsëritja e pyetjeve

Për çdo mësim janë dhënë disa pyetje për përsëritje. Këto mund të përdoren pas mësimit ose javën e ardhshme, para se të jepet mësimi i ri.

Koha e përsëritjes, nëse bëhet me rregull, mund të jetë një mundësi ideale për të përforcuar atë që keni dhënë mësim, ndërsa është edhe argëtuese për fëmijët. Mund ta përdorni këtë kohë për...

- 1 të parë se sa kanë kuptuar fëmijët dhe sa kanë mbajtur mend.
- 2 t'ju ndihmuar se çfarë të theksoni më shumë ndërsa jepni mësim në mënyrë që fëmijët të mbajnë mend më mirë.
- 3 të pasur një kohë argëtimi në klasë. Fëmijët i pëlqejnë garat dhe mezi i presin këto pjesë të programit. Por është më shumë se sa vetëm një lojë: është një kohë mësimi.

Në tekst janë përfshirë vetëm pyetjet mbi mësimin. Do të ishte e dobishme që të përfshiheshin edhe pyetje mbi këngët, vargjet dhe çdo gjë tjetër për të cilën do të jepni mësim. Kështu fëmijët do të kuptojnë se çdo pjesë e programit është e rëndësishme.

Mësimi 1

Bariu i Mirë

Qëllimi: Të përballosh frikën në fuqinë e Zotit.

Psalmi 46:2 - “Prandaj ne nuk do të kemi frikë edhe sikur toka të luajë dhe malet të hidhen në mes të detit.”

Mësimi

Piktura 1-1

“Shiko, Noli! Është një kafshë e frikshme në qoshe të dritares. Mund ta shoh shumë qartë në errësirë..”

Sigurisht që nuk kishte ndonjë kafshë të frikshme, por një vajzë e vogël katër vjeçare mund ta imagjinonte fare lehtë se atje ishte vërtetë një kafshë! Fatmirësisht për Korin, motra e saj, Noli (që ishte gjashtë vjeçe) flinte me të në të njëjtin krevat.

“A mund të kapem pas këmishës tënde, Noli? Kështu nuk do të kem frikë,” tha Kori. Por kur Noli donte të rrotullohej, ajo nuk mundej sepse duart e vogla të Korit ishin ende të kapura fort pas këmishës së saj. Është e vështirë të flesh kështu.

Kështu që natën tjetër Noli i tha motrës së saj, “Nuk e kam të lehtë kur kapesh pas këmishës sime, Kori. Më mirë kapu pas këmishës së kukullës tënde. Edhe kjo të ndihmon!”

Dhe Noli kishte të drejtë. Funksionoi!

Mëngjesin tjetër kur Kori u zgjua, shtëpia ishte plot gjallëri. Betsi, motra tjetër e Korit, e ndihmoi atë të vishej. Mamaja po këndonte poshtë shkallëve, dhe Uillem (vëllai i saj i madh) po kërkonte thasë të pastër. Tre hallat (që jetonin në të njëjtën shtëpi) mund të dëgjoheshin ndërsa bisedonin me njëra tjetrën. Ndërsa po hanim mëngjesin mamaja po na jepte çajin dhe halla Ana po priste bukën. Babai tashmë kishte gati psalmin që do t'i lexonte më vonë familjes.

Kori e vogël nuk po e kuptonte më pse ishte frikësuar aq shumë. Shpejt vëllai dhe motra e saj u nisën për në shkollë dhe Kori mund të ndihmonte hallë Ana në shtëpi. Hallë Ana kishte ardhur të jetonte me ta sepse mamaja shpesh ishte e sëmurë dhe nuk mund të kujdesej për familjen ashtu si dëshironte ajo. Hallë Ana qëronte patatat dhe Kori i vendoste ato në ujë. Ajo po përpiquej që të mos spërkaste shumë! Ndonjë herë halla i kërkonte asaj që të shkonte dhe të merrte diçka poshtë. Kur hallë Ana piqte diçka të mirë, Kori lejohej që ta lëpinte të gjithë tasin. Sigurisht që ata bisedonin shumë bashkë dhe hallë Ana i tregonte historitë “e mira të kohërave të vjetra”.

“Kur ti ishe një bebe e vogël, qaje gjithë kohën. Pastaj unë të mbështillja në përparësen time dhe të mbaja në kurriz. Kjo të qetësonte menjëherë.”

“Unë isha shumë e vogël atëherë, apo jo hallë?”

“Po shumë e vogël. Tani nuk të marr dot në kurriz. Je shumë më e madhe!”

“Të lutem më trego më shumë për kohët e vjetra, hallë Ana.”

Piktura 1-2

Hallë Ana nuk ishte e vetmja që mund të tregonte histori të bukura. Mamaja gjithashtu tregonte histori të bukura! Ajo që i pëlqente më shumë Korit ishin historitë e Biblës.

Mamaja i tregoi asaj për bariun që kishte njëqind dele dhe që kujdesej shumë për to. Ato dele dhe qengja ndiheshin vërtetë të sigurt tek bariu. Kurrë nuk kishin frikë, sepse e dinin se ai po i mbronte. Por, një ditë, njëra nga delet u largua. Sa e frikësuar ishte ajo dele e vogël, ishte vetëm në errësirë! A dini se çfarë bëri bariu kur vuri re që ajo dele ishte zhdukur? Ai shkoi të kërkonte për atë dele dhe nuk ndaloi së kërkuari derisa e gjeti. Sa i lumtur ishte ai ndërsa e mbante në shpinën e tij!

Shikoni Gjoni 10:11 dhe Mateu 18:12-13.

Lexojeni vetë vargun nga Bibla juaj, ose ta lexojë një fëmijë më i rritur.

Zoti Jezus tha, “Unë jam Bariu i mirë.” Ai dëshiron të kujdeset për ty, pikërisht ashtu si bariu kujdesej për delet. Ai tha, “Bariu i mirë jep jetën e vet për delet e tij.” Ai vdiq në kryq dhe u ringjall për ty. Ai mori ndëshkimin që ti meritoje për gabimet që ke bërë. Dhe për shkak të kësaj, Perëndia mund të ta falë të gjithë mëkatin. Bibla thotë, “Ne të gjithë endeshim si dele; secili prej nesh ndiqte rrugën e vet” (Isaia 53:6). Zoti Jezus, Bariu i Mirë, të do ty. Nëse kthehesh tek Ai dhe i kërkon të të shpëtojë, Ai do të ta falë mëkatin dhe do të të bëjë ty fëmijën e Tij, qengjin e Tij.

Korit i pëlqente shumë kjo histori! Mamasë i duhej ta tregonte atë pa pushim.

Kur ishte pesë vjeçe Kori i kërkoi Zotit Jezus që t’ia falte mëkatet dhe të vinte në jetën e saj. Ajo e dinte që Jezusi ishte Miku i saj dhe se do të ishte gjithmonë me të, edhe në errësirë. Ajo nuk kishte më frikë kur flinte natën. Nuk i duhej të mbahej më tek këmisha e Nolit as tek këmisha e kukullës. Në vend të kësaj ajo filloi t’i fliste Zotit Jezus kur ishte errësirë. Ajo i tregonte Atij gjithçka. Nuk mund ta shohësh Zotin Jezus, por Ai mund të të shohë ty dhe Ai dëgjon çdo gjë që ti i thua Atij, edhe kur flet me zë të ulët.

Piktura 1-3

Ka kaq shumë njerëz në nevojë në botë. Nëse je i krishterë, duhet të lutesh për ta dhe të përpiqesh t’i ndihmosh.

Shumë afër shtëpisë së tyre ishte Smedestraat (Rruga e Farkëtarit). Në atë rrugë kishe shumë pijanecë. Për shkak të kësaj ata grindeshin shpesh dhe fillonin të përlesheshin. Kori i urrente përleshjet. Sa herë që shihte njerëz që luftonin shkonte me vrap në shtëpi duke qarë. Kur kishte një përleshje të madhe vinin policët dhe i çonin ata njerëz në rajon. Një ditë ajo pa policët që po merrnin disa burra.

“Ata njerëz do të futen në një qeli të errët dhe të ftohtë” mendoi ajo, “dhe ndoshta ata janë shumë të trishtuar dhe të vetmuar në burg.”

A mund të bënte Kori ndonjë gjë për këta njerëz?

Vetëm Perëndia mund t'i ndryshonte jetët e tyre. Por Kori mund të lutej për ta. Para se të shkonte të flinte në mbrëmje ajo i foli Zotit për atë që kishte ndodhur atë ditë. Ajo i mbaroi lutjet e saj “Dhe Zot, të lutem shpëtoi të gjithë njerëzit në Smedestraat?”

Shumë vite më vonë, kur Kori u rrit, ajo shkoi në kamp me një grup vajzash. Një natë ndërsa Kori u kishte folur atyre për Zotin Jezus, njëra nga vajzat i tha asaj, “A e di që jam fqinja jote? Jetoj në rrugën afër shtëpisë tënde, në Smedestraat!”

“Edhe unë!” tha një vajzë tjetër.

“Mamaja ime jetonte atje më parë,” tha përsëri një vajzë tjetër.

Dhe më pas grupi i vajzave filluan të flasin dhe e dini çfarë? Ose ato jetonin në Smedestraat, ose kishin jetuar atje më parë, ose babi ose mami i tyre kishin jetuar atje më parë. Dhe pikërisht këtyre vajzave Kori po i mësonte për Zotin Jezus. Shumë prej vajzave i kërkuan Zotit Jezus që të ishte Shpëtimtari i tyre. Perëndia i ishte përgjigjur lutjes që Kori kishte bërë në fëmijëri, “Zot, të lutem shpëtoi të gjithë njerëzit në Smedestraat?”

Piktura 1-4

Kori u kthye me mamanë dhe Nolin në shtëpi dhe fytyra e saj ishte zbardhur si një çarçaf.

“Është e tmerrshme,” mendoi ajo “Është e tmerrshme.”

Kur ato arritën në shtëpi, ajo vrapoi lart në dhomën e saj dhe u mbështet tek rafti. Ndihej keq. Lotët i lagën sytë. Çfarë kishte ndodhur?

Së bashku me mamanë e saj dhe Nolin, Kori kishte shkuar atë pasdite për vizitë tek disa njerëz shumë të varfër. Ata jetonin katin e fundit të një shtëpie të vjetër, ku kishin vetëm një dhomë. Në atë dhomë ata duhet të flinin, hanin, gatuanin, lanin – gjithçka aty. Por nuk ishte kjo gjë që e bëri Korin të ndihej keq. Jo, ishte diçka edhe më e keqe. Bebja e vogël, që kishte lindur në shtëpi kishte vdekur. Kur Kori dhe mamaja dhe motra e saj kishin hyrë në dhomë, ato kishin parë fëmijën e vogël të vdekur të shtrirë në djep. Vajzat e kishin prekur për një çast fëmijën e vdekur, por kur Kori e kishte ndierë se sa i ftohtë ishte fëmija, ajo ishte shokuar

kaq shumë sa që kishte vrapuar tek mamaja e saj dhe kishte fshehur kokën në prehrin e saj. Papritur Kori kishte kuptuar se çfarë do të thoshte vdekje dhe gjithashtu se një ditë të gjithë do të vdesin – babai, mamaja, Betsi, Uillem, Noli, hallat. Vetëm imagjino nëse të gjithë këta do të vdisnin dhe ajo do të mbetej vetëm ...

“Kori, darka është gati! Eja poshtë!” thirri Noli.

Ngadalë Kori zbriti shkallët. Ajo u ul tek tavolina ovale me të tjerët. Ajo nuk donte të hante darkë.

“Kori, zemër, ha pak, nuk ke ngrënë asgjë.”

Kori përtypi ngadalë sanduiçin e saj. Ajo pa familjen rrotull saj dhe mendoi.: “Vetëm imagjino ...”

Mendoj se mamaja e Korit e kuptoi pse ajo dukej aq e zbehtë, por Kori nuk guxoi të fliste një fjalë. Ndoshta ke përjetuar të njëjtën gjë si Kori – diçka po të shqetëson, por nuk mund t’ia tregosh askujt se si ndihesh.

Piktura 1-5

Lexojeni vetë vargun nga Bibla juaj, ose ta lexojë një fëmijë më i rritur.

Kur mbaroi darka, babai mori Biblën e tij. Ai filloi të lexonte psalmin 46. Në vargun 2 thuhet, “Prandaj ne nuk do të kemi frikë edhe sikur toka të luajë dhe malet të hidhen në mes të detit.”

Në atë moment Kori kuptoi se, çfarëdo që të ndodhi, Perëndia është gjithmonë me fëmijët e Tij.

Shumë ngadalë, sa vetëm Zoti Jezus mund ta dëgjonte, ajo filloi të lutej, “Jezus, e di që Ti do të jesh gjithmonë me mua. Por të lutem lëri të afërmit e mi të jenë me mua edhe për shumë kohë. Ata do të të jenë në Qiell për një kohë të gjatë – unë nuk mundem pa ta.”

Kur Kori po shkonte në shtrat atë natë, babai i saj erdhi që ta vërë në gjumë. Ai e bënte këtë çdo natë. Tani që ishte vetëm me babain e saj, ajo guxoi t’i tregonte atij se nga se frikësohej kaq shumë.

“Babi, kam shumë frikë se mos ju të gjithë vdisni dhe se mos unë mbetem vetëm.”

Babai përkëdheli fytyrën e Korit duke e qetësuar.

“Kori,” tha ai, “kur të duhet të shkosh diku me tren, kur t’i kam dhënë paratë për biletën? Dy javë përpara?” “Jo, sigurisht që jo. Pikërisht para se të largohem.”

“Dhe Ati ynë në Qiell bën pikërisht të njëjtën gjë me ne. Nëse mamaja ose unë ose hallat do të vdisin, vetëm atëherë Perëndia do të të japë ty forcën për të mbajtur dhimbjen. Por përderisa nuk ka ndodhur, nuk duhet të kesh frikë tani.”

Kori u sigurua. Kurrë, edhe kur u rrit, ajo nuk i harroi ato që babai i kishte thënë asaj atëherë.

ndoshta ke frikë se mos të ndodh ndonjë gjë e tmerrshme, edhe pse beson në Zotin Jezus. Ndoshta ke frikë se dikush që ti e do shumë vdes, ose se shtëpia jote do të vidhet, ose se dikush mund të të lëndojë rrugës për në shkollë. Mos ki turp për shkak të frikës që ke. Tregoji Zotit Jezus dhe Ai do të të ndihmojë. Ai do të të japë ty forcë për të përballuar edhe vështirësitë më të mëdha që mund të imagjinosh. Por për aq kohë sa kjo gjë e tmerrshme nuk ka ndodhur, nuk duhet të kesh frikë prej saj.

Shumë fëmijë kanë vërtetë frikë. Ndërsa e jepni mësim këtë pjesë të historitë, mund të flisni me fëmijët për frikërat që ato kanë.

Piktura 1-6

Një vajzë e vogël po qëndronte në shkollë. Ajo kishte veshur një fustan të pastër, çorape të zeza dhe çizme të gjata të mbërthyera me kopsa. Kështu visheshin vajzat në ato ditë. Por mund të kuptoni prej fytyrës së vajzës se ajo ishte shumë e frikësuar dhe e zemëruar. I kishte ngulur këmbët në dysheme dhe mbahej fort pas parmakëve të shkallëve me të dyja duart, aq fort sa mundej.

“Nuk dua të shkoj në shkollë. Nuk dua të shkojë në shkollë. Dua të rri në shtëpi!”

“Por, Kori, në shkollë do të mësosh të lexosh.”

“Unë di të lexoj!”

“Dhe atje mund të mësosh matematikë ...”

“Mund të ma mësoj babi matematikën!”

“Nuk dëshiron të luash me fëmijët e tjerë?”

“Jo, nuk dua! Duhet të ndihmoj hallë Anën dhe të kujdesem për Kasparinën, kukullën.”

“Si është puna?” pyeti babai. Ai donte të dinte se çfarë po ndodhte.

“Kori nuk do të shkojë në shkollë.”

“Por të gjithë gjashtë vjeçarët shkojnë në shkollë. Ke nevojë të mësosh!” “Dua të rri në shtëpi, kam frikë të shkojë në shkollë.”

“A, kështu qenka puna! Ke frikë të shkosh vetëm në shkollë? Mirë, ne do të shkojmë të dy.”

Z. Ten Bum veshi pallton e tij dhe kapelën dhe zgjati dorën të kapte dorën e Korit. Por Kori mbahej fort tek parmaku me të dhjetë gishtat. Sidoqoftë, gishtat e babait të saj ishin më të fortë dhe ai i liroi secilin prej atyre gishtave të vegjël nga parmaku. Pastaj ai kapi dorën e saj fort dhe e çoi në shkollë.

A mund t'i mendoni të dy duke ecur në rrugë? Ai zotëri i gjatë i veshur bukur, duke mbajtur vajzën e tij të vogël nga dora. Fytyra e Korit e skuqur dhe me lotë. Ajo po qante,

“Nuk dua, nuk dua të shkoj në shkollë.”

Por babai i saj ishte i fortë dhe i vendosur. Ai e çoi atë deri tek klasa. Dhe pastaj e puthi duke i thënë, “Kori, e dashur, kur të mbarojë mësimi, në orën dymbëdhjetë, do të jem duke të pritur!”

Kështu ndodhi për tre ditë. Por në ditën e tretë Kori pa një baba tjetër që po vinte me djalë e tij në krahë i cili po qante.

“Oh, sa e mërzitshme!” mendoi Kori. Pastaj ajo e kuptoi, “Edhe unë po sillem ashtu!” Befas pushoi së qari.

Babi nuk kishte nevojë më ta tërhiqte për në shkollë. Ajo shkante në shkollë me Noli. Dhe e dini çfarë, ajo zbuloi se, në fund të fundit, shkolla nuk ishte dhe aq e keqe! Ndiresh mirë kur je në gjendje të bësh një mbledhje të vështirë vetë, ose kur e di përgjigjen e një pyetjeje të vështirë dhe mësuesi të thotë, “Të lumtë!”

Kushërira e Korit Dot kishte të njëjtën moshë me të.

Së bashku ato luanin në kishën e madhe të Haarlemit. Babai i Dotit ishte kujdestari i kishës dhe nuk e kishte problem nëse vajzat luanin atje. Një pasdite ndërsa po bëhej errësirë, Kori po shikonte dritat e zbehta të mbrëmjes që shkëlqenin përmes dritareve me xhama me ngjyra. Kjo i kujtoi asaj se Jezusi është drita e botës. Dhe kjo e lumturoi atë shumë.

“Kori, shkojmë në shtëpi, kam frikë!” tha Dot.

“Frikë?” Kori nuk e kuptoi. “Si mund të kesh frikë kur Zoti Jezus është këtu me ty dhe mua?”

Pyetjet e përsëritjes

- 1 Thoni një gjë nga e cila Kori kishte frikë, kur ishte shumë e vogël. (Kafshët e frikshme, të shkuarit në shkollë, vdekja).
- 2 Cila histori nga Bibla i pëlqente më shumë Korit? (Historia e Bariut të Mirë).
- 3 Kush është Bariu i Mirë? (Zoti Jezus).
- 4 Si mund t'i përkasësh Bariut të Mirë, Zotit Jezus? (Duke u kthyer te Zoti Jezus dhe duke i kërkuar Atij të të shpëtojë).
- 5 Çfarë bëri Kori për njerëzit nevojtarë në Smedestraat? (Ajo u lut për ta.)
- 6 Pse nuk duhet të kemi frikë për gjërat që nuk kanë ndodhur ende? (Sepse mund t'i besojmë Zotit se do të na japë forcë për t'i mbajtur ato, në kohën e duhur).
- 7 Çfarë bëri babai i Korit, kur Kori nuk donte të shkante në shkollë? (Ai e çoi atë në shkollë).
- 8 Nëse jemi të krishterë, çfarë na bën të mos kemi frikë? (Të dimë që Zoti Jezus është gjithmonë me ne).

Mësimi 2

Një familje e lumtur

Qëllimi: Për të parë rëndësinë e të shërbyerit Zotit që në moshë të hershme.

Psalmi 1:1,3 - “Lum njeriu që nuk ecën sipas këshillës të të pabesëve ... Ai do të jetë si një pemë e mbjellë gjatë brigjeve të ujit, që jep frytin e tij në stinën e tij.”

Është mirë që të gjatë historisë të shpjegoni që fjala “pemë” në gjuhën hollandeze është “bum”. (Ai do të jetë si një “Bum”.) Familja Ten Bum e mori këtë varg si inkurajim prej Zotit, kur morën lajmin se Betsi dhe Kori ishin transportuar për në Ravensbrück.

Mësimi

Piktura 2-1

“Kori, a je gati? Le të shkojmë!”

Babai i Korit ishte orë-ndreqës. Ai riparonte orët. Ai kishte nevojë të shkonte në Amsterdam për të gjetur pjesë.

Babai por priste poshtë shkallëve që Kori të vinte. Lart Betsi kishte larë fytyrën dhe duart e Korit me sapun. Gjithashtu ishte kujdesur që ajo të kishte një fustan të pastër. Sepse kur të shkoje në Amsterdam me babin, duhet të ishe veshur mirë..

“Kori, e dashur, dukesh shumë mirë sot!” tha babai. “Më jep dorën dhe do të shkojmë.”

Ata shkuan me tren. Kori mund të ulej në anën e dritares. Kishte shumë gjëra për të parë! Kishte shumë gjëra! Së pari shtëpitë e pjesës së brendshme të qytetit, pastaj shtëpitë e të pasurve dhe pastaj livadhet me lopë dhe dele. Pas gjysmë ore ata mund të shikonin shtëpitë e Amsterdamit. Stacioni Qendror kryesor i Amsterdamit është vendosur buzë ujit dhe quhet Y. Atje ka shumë anije. Në majë të kambanores kishte një shtyllë të gjatë, në mënyrë që njerëzit nëpër anije ta shihnin më mirë. Në shtyllë ishin vënë dy akrepa të lëvizshëm. Ata tregonin për lart, por saktësisht në orën dymbëdhjetë të drekës (dhe asnjë sekondë më vonë!) ato uleshin poshtë. Nëse do të kishe një pozicion të mirë në Stacionin Qendror, mund ta shikoje edhe nga aty. Më vonë kur mbaronin së vizituarit dyqanet e veçanta që shisnin pjesë për orë, Kori dhe babai i saj shkonin ta shikonin.

Në dyqane babai blinte shumë gjëra që duheshin për riparimin e orëve. Gati të gjithë njerëzit që i kishin këto dyqane ishin hebrenj dhe miq të mirë të babait të Korit. Ata gjithmonë i jepnin një ëmbëlsirë Korit. Në shtëpi zor se gjeje para për ëmbëlsira, kështu që mund ta kuptoni se sa i pëlqente asaj ky trajtim.

Kori dhe babai i saj u siguruan që të vinin në Stacion Qendror në drekë. Në shtëpi, familja Ten Bum kishte një orë që shkonte shumë mirë. Të gjitha orët që rregullonte babai i Korit viheshin sipas saj. Por ora në Amsterdam ishte edhe më e saktë. Dy akrepat uleshin poshtë ekzaktësisht në orën dymbëdhjetë. Babai i Korit qëndroi në majë të gishtave që ta shihte. Bam! Shkuan poshtë! Babai shikoi orën e tij.

“Dy sekonda përpara,” shkroi ai në fletoren e tij.

Kur të ktheheshin në shtëpi, ai do ta vendoste saktë me sekonda orën e tyre. Rugës për në shtëpi ata bisedonin në tren. Kori mund të pyeste babin për shumë gjëra, sepse hallat nuk ishin aty. Babai i saj kurrë nuk i trajtonte pyetjet e saj si të çuditshme dhe gjithmonë jepte një përgjigje. Ndonjëherë babai mendonte se Kori ishte shumë e vogël për të ditur disa gjëra dhe ai do të thoshte diçka të tillë.

“Kori, a do të mund të mbaje valixhen e rëndë plot me pjesët e orëve?”

“Jo, babi,” u përgjigj Kori, “është shumë e rëndë për mua.”

“Në rregull, Kori. Për aq kohë sa ti je shumë e vogël, unë do ta mbajë valixhen. Në të njëjtën mënyrë, ka disa gjëra në jetë për të cilat ti je shumë e vogël për t’i ditur. Mjafton që babi dhe mami e dinë.”

Kori e donte shumë babain e saj. Në fakt ai i sillte pak në mend asaj një Baba tjetër. Ai i sillte në mend asaj Perëndinë, Atin e Zotit Jezus që ishte gjithashtu edhe Ati i saj, sepse ajo i përkiste Zotit Jezus. Sepse Kori besonte në Zotin Jezus. Ajo e dinte që Ai kishte vdekur dhe ishte ringjallur. Ajo i kishte kërkuar Atij që ta shpëtonte prej mëkateve. Ndoshta babai yt ka vdekur ose nuk jeton më me ty. Mbaj mend që Perëndia dëshiron të kujdeset për ty, të të ndihmojë dhe të të ngushëllojë kur je i trishtuar. Kurrë nuk tallet me ty. Nëse i përket Zotit Jezus, Perëndia do të jetë gjithmonë me ty. Ai kurrë nuk të zhgënjën.

Piktura 2-2

Kur ata mbërrinin në shtëpi, hallë Ana kishte gjithmonë gati ushqim për ta. Ajo e bënte ushqimin të shijshëm dhe të mirë. Kjo nuk ishte një gjë e lehtë për t’u bërë për nëntë persona (dhe ndonjëherë edhe më shumë) kur ke vetëm pak mish, pak perime dhe disa patate.

Hallë Ana nuk punonte për familjen Ten Boom falas për asgjë. Çdo javë babai i jepte asaj një gilder (kjo ishte monedha që përdorej në Hollandë në atë kohë). Kjo ishin shumë para për atë kohë në fillim të 1900-ës. Shpesh ndodhte që në fund të javës kur duhet të paguheshin, furrtari, kasapi dhe shitësi i ushqimeve,

nuk kishte më para. Pastaj babai do të shkonte tek hallë Ana dhe do t'i pëshpëriste, “Ana, e ke akoma gilderin tënd?”

Gilderi ishte gjithmonë atje. Mendoj se hallë Ana nuk e shpenzonte ndonjëherë për veten atë gilder.

Ashtu siç thashë kishte më shumë se nëntë njerëz në shtëpi. Miqtë ishin gjithmonë të mirëpritur tek Ten Bum-ët. Ishte një kohë e veçantë. Në tavolinë ishte një kuti e vogël metalike ku futeshin paratë për misionin. Sa herë që ndodhte diçka e veçantë, zonja Ten Bum fuste një monedhë një-centëshe në kuti. Ajo e quante atë “kutia e bekimit”. Atë mbrëmje ishin dy miq dhe kishte arsye pse të futej një cent në kutinë e bekimeve. Faktikisht hallë Ana nuk e kishte llogaritur se do të kishte edhe dy të ftuar më shumë, kështu që ajo i hodhi ujë supës dhe qëroi edhe disa kokrra patate më shumë. Miqtë nuk e kishin problem se supa ishte e hollë dhe se kishin vetëm një copë të vogël mishi.

Piktura 2-3

Kishte diskutime interesante gjatë atij vakti. Ata nuk folën për njerëz të tjerë apo për gjëra që nuk kishin rëndësi. Ishte një atmosferë e gëzueshme ku miqtë ndiheshin si në shtëpinë e tyre. Mbi të gjitha ata e vunë re se Zoti Jezus ishte i rëndësishëm për të gjithë në shtëpi dhe se Ai ishte i pranishëm në çdo bisedë. Dy miqtë dëgjuan me kujdes ndërsa babai lexoi disa vargje nga Bibla në fund të vaktit.

Një nga miqtë kishte një problem dhe dëshironte të fliste vetëm me babain.

“Eja tek punishtja,” tha z. Ten Bum.

Pasi folën së bashku ata u lutën. Babai e dinte se Perëndia ishte në gjendje të zgjidhte çdo problem. A nuk e kishin përjetuar edhe ata vetë këtë? – nëse babai nuk dinte se si të rregullonte një orë të prishur; nëse mamaja ishte sëmurë; dhe në kohën kur babai nuk kishte pothuajse fare para, sepse dikush e kishte mashtruar. Në kohë të tilla ata kishin mësuar se Zoti kishte përgjigjet për problemet, edhe nëse ishin probleme parash ose sëmundjeje, edhe nëse u kishte ndodhur diçka e keqe, ose nëse dikush i kishte trajtuar keq. Dhe jo vetëm kaq, Zoti të jep gëzim edhe kur ne kalojmë nëpër shumë probleme të vështira.

Ndoshta mendoni se jeta është e mirë vetëm kur ke shumë para dhe kur mund të veshësh rroba të shtrenjta, kur mund të blesh lodra të bukura dhe të kesh pushime të gjata në vende të tjera. Këto janë gjëra të mrekullueshme, por nuk mund të të ngushëllojnë kur je i trishtuar. Gjithashtu mund të vijë një kohë kur mund t'i humbasësh të gjitha këto gjëra. Ato kurrë nuk mund të të bëjnë të lumtur. Nëse familja jote nuk ka shumë para për të bërë gjëra që kushtojnë shumë, mos u trishto për këtë. Perëndia nuk dëshiron që ti të jesh xheloz për djemtë dhe vajzat e tjerë që mund të bëjnë këto gjëra. Ji falënderues për gjithçka që ke.

Lexojeni vetë vargun nga Bibla juaj, ose ta lexojë një fëmijë më i rritur.

Gjëja më e rëndësishme në jetë është që ti i përket Zotit Jezus. Në kryq Ai mori ndëshkimin për të gjitha gabimet që bëjmë ne. Ai vdiq, por gjithashtu Ai u ringjall dhe u kthye në Qiell. Ai dëshiron që të jetoj në zemrën dhe jetën tënde. Ai dëshiron që të falë mëkatet e tua dhe të të bëjë ty ashtu siç dëshiron Ai, në mënyrë që një ditë të jesh në Qiell me Të përgjithmonë. Ai dëshiron që të jesh me Të në Qiell përgjithmonë. Mund t'i kërkosh Atij që të vijë në jetën tënde që tani. Thuaji Atij, "I dashur Zoti Jezus, Unë kam gabuar. Faleminderit që vdiqe në kryq për mua. Fali mëkatet e mia dhe merr në kontroll jetën time." Ai premton se do të vijë në jetën tonë, nëse ia kërkojmë Atij (Zbulesa 3:20). Ai do të të japë ty gëzim dhe paqe që askush nuk mund të ta heqë.

Piktura 2-4

Përveç hallë Anës, në shtëpi ishin edhe dy halla të tjera - halla Bet dhe halla Jans. Fëmijët nuk e pëlqenin shumë hallë Bet-in. Ajo kishte qenë një guvernante për fëmijët e familjeve të pasura. Sigurisht që edhe ata fëmijë kishin qenë të prapë herë pas here, si të gjithë fëmijët e tjerë, por hallë Bet e kishte harruar të gjithë këtë.

Kur Kori ose Betsi vonoheshin të vinin në tavolinë për darkë, hallë Bet thoshte, "Fëmijët e familjes Ualler kurrë nuk vinin vonë." Kur Kori rrëshqiste në parmakun e shkallëve, kjo ishte diçka të cilën fëmijët Ualler nuk do ta bënë kurrë. Dukej sikur ata kurrë nuk e kishin pasur hundën pis, duart pis ose këpucët pis. A e besoni këtë?

Faktikisht jeta nuk kishte qenë e lehtë për hallë Bet-in. Njerëzit e atyre familjeve të pasura nuk ishin sjellë mirë me të. Prandaj ajo ankohej aq shumë. Zonja Ten Boom gjithmonë përpiquej që të ishte e mirë me hallë Bet-in që ajo të mos ankohej.

Hallë Jans kishte qenë e martuar me një shërbyes kishe. Burri i saj kishte vdekur para se ajo të mbushte dyzet vjeç, kështu që edhe ajo kishte ardhur të jetonte me familjen Ten Bum. Ishte një person shumë i gëzueshëm. Punonte gjithë ditën. Kishte shkruar libra dhe poezi dhe kishte filluar të redaktonte një revistë të përmuajshme për gra. Hallë Jans merrte çdo muaj një pension të vogël mujor për të vejat. Ajo nuk e mbante atë për vete. Ajo blinte veshje për vajzat. Sa mirë ishte të merrje herë pas here rroba të reja. Por sa keq që hallë Jans nuk kishte shije për sa i përket veshjeve. Veçanërisht Nolit dhe Betsit nuk i pëlqente kur hallë Jans vinte në shtëpi përsëri me një fustan të shëmtuar ngjyrë gri, ose me një kapele që nuk e mbante asnjë vajzë tjetër. (Në atë kohë të gjitha vajzat vinin kapele). E vetmja që nuk e kishte shumë problem këtë ishte Kori, kështu që hallë Jans ia jepte asaj pjesën më të madhe të kapelave dhe të fustaneve.

Ndonjëherë hallë Jans vinte në shtëpi me diçka shumë të mirë - një ëmbëlsirë për shembull, edhe pse nuk ishte ditëlindja e askujt. Kjo ishte e veçantë. Më vonë, kur Kori u rrit, ajo shkroi për hallë Jans, "Unë besoj se ajo është personi më i pasur që kam takuar ndonjëherë, sepse asaj i pëlqente t'i jepte të tjerëve."

Piktura 2-5

Në Haarlem, në Hollandë, kishte kazerma ushtrie dhe gjithashtu kishte shumë ushtarë në qytet. Një ditë, kur hallë Jans po ecte në rrugë, ajo pa se ushtarët por rrinin kot në kohën e tyre të lirë.

“Kjo nuk është mirë,” mendoi ajo. “Nëse këta njerëz rrinë kot dhe janë të mërzhitur, do të futen në telashe. Duhet bërë diçka për këtë. Por çfarë?”

Papritur hallë Jans kishte një ide. Pse të mos fillojmë një klub për ushtarë, që të shkojnë atje në kohën e tyre të lirë, në vend që të rrinë të mërzhitur. Madje edhe më mirë, ata mund të dëgjojnë për Zotin Jezus.

Kur hallë Jans-i kishte ndër mend të bënte diçka nuk kalonte shumë kohë dhe ajo gjë ndodhte. Shpejt ushtarët filluan të vinin në dhomën që hallë Jans-i kishte bërë gati. Atyre i pëlqente që të bënin diçka. Një rreshter të cilin hallë Jans-i e kishte takuar në tramvaj, pa organon e saj të vogël në një cep të dhomës dhe e pyeti nëse mund të luante në të.

“Sigurisht,” tha ajo dhe shumë shpejt tingulli i muzikës së organos u dëgjua në të gjithë shtëpinë.

Askush në familjen Ten Bum nuk mund të luante mirë në organo. Hallë Jans-i dëgjonte plot admirim. Kur ai mbaroi së luajturi ajo, “A mund t’i mësosh dy mbesat e mia Noli dhe Kori se si të luajnë në organo?”

“Sigurisht,” tha rreshteri.

Korit dhe Nolit i pëlqeu shumë ideja, sepse e pëlqenin muzikën. Shumë shpejt ato mund të luanin kaq mirë sa mund të shoqëronin dikë që këndonte.

Piktura 2-6

Shpejt kaq shumë ushtarë filluan të vinin në dhomën e hallë Jans-it, nuk mund t’i nxinte të gjithë. Por si gjithmonë hallë Jans-i kishte një zgjidhje. Një ditë të gjithë ndihmuan për pastrimin e dhomës, të servisit të argjendte të hallë Jansit dhe u kujdesën që çdo gjë të ndriçonte. Atë pasdite nuk do të vinin ushtarë për vizitë, por zonja të pasura aristokrate. E gjeni dot se çfarë lidhje kishin këto me ushtarët?

Zonjat ngjitën shkallët e ngushta për tek dhoma e hallë Jans-it dhe pinë nga një filxhan çaj. Pastaj hallë Jans-i filloi historinë e saj. Ajo tregoi për ushtarët të cilët rrinin kot në Haarlem dhe të cilët kishin nevojë të shkonin diku, që të kalonin kohën e tyre të lirë në mënyrë të dobishme. Dhoma ku ato ishin tani ishte shumë e vogël. Faktikisht duhej një qendër argëtimi ku ata të ndiheshin si në shtëpinë e tyre.

Zonjave u pëlqeu ideja dhe dhanë para për të ndërtuar një qendër për ushtarakët. Sapo u ndërtua qendra, hallë Jans-i shkante atje dy herë në javë për të dhënë një studim biblik. Noli ose Kori shkonin me të për të luajtur në organo. Ato gjithashtu këndonin për ushtarët. Në këtë mënyrë ato mësuan të bënin diçka për Zotin që në moshë të hershme. Më vonë në jetën e saj Kori do t'i tregonte shumë njerëzve për Zotin Jezus. Ajo ende nuk e dinte këtë, por Perëndia e dinte. Dhe kur ishte e re, Zoti e drejtoi atë, që në qendër të mund të mësonte se si t'i fliste për Shpëtimtarin, gupeve të njerëzve..

Perëndia ka një plan për jetën tënde gjithashtu – për tani, ndërsa je akoma i vogël dhe edhe më vonë kur të rritesh. Mendo se si mund të fillosh, që tani, të mësosh të bësh gjëra për Zotin Jezus. Çdo gjë që bën për Zotin tani gjithashtu po të përgatit ty për atë që mund të bësh për Të më vonë.

Kjo është një mundësi e mirë për të ndarë ide me fëmijët, se si mund të bëjnë diçka për Zotin Jezus. Asnjë punë që bëhet për Zotin nuk është shumë e vogël.

Pyetjet e përsëritjes

- 1 Çfarë bënte Kori me babain e saj në Amsterdam? (Ajo shkante me të në dyqane të veçanta, për të blerë gjëra që ishin të nevojshme për riparimin e orëve; ajo shikonte bashkë me të orën që ishte afër stacionit.)
- 2 Pse i pëlqente aq shumë Korit të udhëtonte me babain e saj? (Sepse mund të fliste me të për të gjitha gjërat).
- 3 Nga e dini që familja ishte e varfër? (Ata nuk ishin në gjendje të paguanin hallë Anën për punën e saj; kishin pak para për të blerë ushqim).
- 4 Cila ishte një mënyrë me të cilën familja i tregoi Perëndisë dashurinë për të tjerët? (Miqtë ishin gjithmonë të mirëpritur në shtëpinë e tyre).
- 5 Çfarë shihnin të veçantë në familjen Ten Bum, njerëzit që vinin aty për vizitë? (Ata e donin Zotin Jezus dhe Ai ishte i pranishëm në bisedat e tyre).
- 6 Çfarë bëri hallë Jans për ushtarët në Haarlem? (Ajo kishte një dhomë ku ata të mblidheshin dhe bënte një studim biblik për ta).
- 7 Si e përfshiu hallë Jans-i Korin dhe Nolin në këtë punë? (Ata luajtën në organo dhe kënduan për ushtarët).
- 8 Cilat janë disa gjëra që ti mund t'i bësh për Zotin tani? (Të ftosh një fëmijë të vije në shtëpinë tënde për të luajtur me ty, të shkosh për vizitë tek një mik që është i sëmurë, të lutesh për misionarët, të ftosh fëmijë të tjerë në Klubin Lajmi i Mirë etj.)

Mësimi 3

Në shkollën e Perëndisë

Qëllimi: Të mësojmë mësimet që Perëndia na mëson në jetë.

Psalmi 32:8 - “Unë do të të edukoj dhe do të të mësoj rrugën, nëpër të cilën duhet të ecësh; unë do të të këshilloj dhe do ta mbaj syrin tim mbi ty.”

Mësimi

A do të ishe i lumtur nëse nuk do të duhej të shkoje më në shkollë? A nuk do të ishte mirë? Atëherë do të mund të luaje gjithë ditën. Por nuk do të mësoje të lexoje dhe kurë nuk do të kishe mundësi të lexoje një libër të bukur. Nuk do të mësoje matematikën, kështu që nuk do ta gjeje dot se sa para ke kursyer për mono patinën tënde. Të pëlqen apo s’ të pëlqen, në shkollë mëson gjëra që do të të duhen tani dhe më vonë gjithashtu.

Ka edhe një “shkollë” tjetër në të cilën janë të gjithë të krishterët, derisa të shkojnë në Qiell për të qenë me Zotin Jezus. Ti je në këtë “shkollë” nëse e ke pranuar Zotin Jezus si Shpëtimtarin tënd. Perëndia është mësuesi ynë në këtë “shkollë”. Nuk është si shkolla që mendojmë ne – me një mësues që qëndron para klasës. Zoti na mëson ne nëpërmjet Biblës, nëpërmjet të krishterëve të tjerë dhe nëpërmjet gjërave që ndodhin në jetët tona, gjëra të bukura ose të trishtuara.

Piktura 3-1

Kori kishte shkuar në këtë “shkollë” gjithashtu. Kur ishte vajzë e vogël, ajo mësoi se nuk duhet të kishte frikë nga errësira, sepse Zoti Jezus ishte me të. Ajo mësoi të donte të varfrit dhe të lutej për ta. Ajo gjithashtu mësoi se çdo njeri duhet të dëgjonte për Zotin Jezus.

Në shkollën e Perëndisë, mëson më shumë nga gjerat që ke përjetuar vetë. Kur Kori u rrit, ajo u sëmur një ditë.

Ajo shkoi të vizitohej tek një mjek që e kontrolloi dhe i tha, “Kori, ti ke tuberkuloz. Shko në shtëpi dhe qëndro në shtrat. Vetëm pushimi mund të të shërojë.”

Në atë kohë, tuberkulozi ishte një sëmundje shumë e zakonshme dhe e rrezikshme. Ilaçi i duhur për trajtimin e tij nuk ishte zbuluar ende. Shumë njerëz vdisnin nga tuberkulozi.

Lajmi e shokoi Korin. Ajo shkoi në shtëpi dhe shkoi direkt në shtrat. Në fillim shumë njerëz erdhën për vizitë për të. Sidoqoftë, ndërsa mbeti e sëmurë për shumë kohë gjithnjë e më pak njerëz vinin. Ajo rrinte shtrirë në shtrat. Nuk e kuptonte pse Perëndia kishte lejuar që ajo të ishte kaq e vetmuar dhe kaq e sëmurë. Ajo ishte e zemëruar me Perëndinë. Por Perëndia i mësoi asaj se si të pranonte faktin se ishte sëmurë, megjithëse nuk e kupton pse.

Në atë shkollë të Perëndisë Kori mësoi të thoshte “faleminderit Zot”, edhe pse ndonjëherë ishte e trishtuar dhe e vetmuar.

Një ditë Kori kishte një dhimbje në stomak. U thirr doktori dhe ai zbuloi se ajo nuk kishte tuberkuloz – ajo kishte apendicitin. U dërgua drejt e në spital. Pas operacionit ajo ishte përsëri me shëndet të mirë.

Piktura 3-2

Betsi, motra e madhe Korit, jepte mësim në shkollën e së dielës. Një ditë ajo bëri një sugjerim.

“Kori, pse nuk vjen herën tjetër për të treguar historinë biblike? Është për ushqimin e pesëmijë vetave.”

Kori nuk e kishte problem. Ajo e dinte historinë shumë mirë, kështu që mendoi se mund t’ia tregonte fëmijëve. Fëmijët dëgjuan me vëmendje. Por a mund ta jepte mësimin, teto Kori aq mirë sa e jepte teto Betsi? Sepse kur ajo tregonte një histori, të dukej vetja sikur ishte vetë pjesë e saj!!

Pas pesë minutash Kori e kishte mbaruar historinë e saj. Fëmijët u habitën. Sa shpejt! Kori shikoi e pafuqishme drejt Betsit. Nuk dinte se çfarë të thoshte më. Sidoqoftë Betsi filloi ta tregonte përsëri të gjithë historinë.

“Nuk do ta bëj më kurrë,” tha Kori kur erdhën në shtëpi.

“Hë pra tani,” tha Betsi. “Mos ki një opinion kaq të keq për veten tënde. Nuk ka rëndësi nëse nuk shkoi edhe aq mirë herën e parë. Do të mësosh me kalimin e kohës.”

Fatmirësisht, Kori nuk u dorëzua. Një nga shoqet e saj ishte mësuese në një shkollë të krishterë. Kori i kërkoi asaj që nëse mundej t’i tregonte një histori biblike fëmijëve të klasës së saj, disa herë në javë. Shoqja e ndihmoi atë. Në këtë mënyrë Kori mësoi se si të jepte mësim aq mirë sa të gjithë fëmijët kishin dëshirë ta dëgjonin. Kori madje mori leje të veçantë për të dhënë edukim fetar në shkolla. Para se Kori të shkonte në shkollë për të dhënë mësimin, ajo i kërkonte Perëndisë që t’i tregonte se çfarë dëshironte Ai që ajo t’u mësonte atyre.

Njëra prej shkollave që Kori vizitoi ishte një shkollë për fëmijë me aftësi të kufizuara në të mësuar. Disa prej tyre nuk mund të mbanin mend se çfarë ishte dhënë në mësim në lëndët e tjera në shkollë. Por ata i mbanin mend mësimet që u jepte Kori, sepse ato mësimet ishin për Zotin Jezus dhe ata filluan ta donin Zotin Jezus. Ata nuk mund të bënin mbledhje dhe zbritje. Nuk mund ta kuptonin gjeografinë. Por ata mund të kuptonin që Perëndia nuk i pëlqen gabimet që ata kishin bërë dhe se Zoti Jezus kishte vdekur në kryq për t’i rregulluar gjërat midis tyre dhe Perëndisë. A vinte kjo nga që teta Kori mund t’i tregonte shumë mirë historitë? Jo! Kjo ndodhi sepse ata besuan në Zotin Jezus. Fryma e Shenjtë ua shpjegoi atyre gjërat e vështira të Biblës në zemrat e tyre. Fryma e Shenjtë bën të njëjtën gjë për ty nëse dëshiron t’i përkasësh Zotit Jezus.

Shumë gjëra në Bibël janë kaq të vështira sa edhe një profesor i zgjuar nuk mund t'i kuptoj. Por nëse Fryma e Shenjtë na i qartëson këto gjëra, atëherë edhe një fëmijë i vogël, ose një fëmijë me vështirësi në të mësuarit, mund t'i kuptojë.

Kori gjithashtu filloi një shërbesë kishe të dielave pasdite për njerëz me vështirësi në të mësuar. Këta njerëz nuk e kuptonin një shërbesë të zakonshme kishe dhe ishin shumë të mëdhenj për mësimet e shkollës së dielës. Shumë prej këtyre njerëzve pranuan Zotin Jezus. Dhe njerëzit e aftë mahniteshin me mënyrën se si ata e donin Zotin Jezus.

Piktura 3-3

Kori dëshironte të bënte shumë gjëra. Një ditë ajo i tha babait të saj, “Dua të bëhem një orëndreqëse.”

“Shumë mirë,” i tha babai. “shpresoj që të bëhesh një orëndreqëse më e mirë se unë.”

Ishte e mahnitshme që babai e tha këtë! Ai ishte një prej orëndreqësve më të mirë në Hollandë. Kori kurrë nuk u bë aq e mirë sa babai i saj. Ajo punoi shumë dhe mori çertifikatën e saj të orëndreqësit – gruaja e parë orëndreqëse në Hollandë që merrte çertifikatën.

Riparimi i orëve ishte një përgatitje e mirë për punën me Zotin. Është një punë e detajuar që ka nevojë për shumë durim dhe nëse dëshiron të punosh për Zotin, duhet të jesh i durueshëm. Kori e mësoi këtë duke riparuar orët. Pjesët e orëve janë shumë të vogla. Kur riparon një orë dora jote nuk duhet të dridhet aspak. Atëherë Kori lutej, “Zot Jezus a do të vendosësh dorën tënde mbi timen?” Dhe dora e saj nuk dridhej më.

Vitet kaluan. Shumë gjëra ndryshuan në familjen Ten Bum. Tre hallat u plakën dhe vdiqën. Mamaja kishte qenë e sëmurë për një kohë të gjatë dhe gjithashtu kishte shkuar të jetonte me Zotin Jezus. Noli dhe Uillem ishin martuar dhe kishin fëmijët e tyre. Tani vetëm babai, Betsi dhe Kori jetonin në shtëpinë e familjes në Bartejorisstraat, në Haarlem.

Por jo për shumë kohë! Një mbrëmje Uillem erdhi për vizitë. Ai u tregoi atyre për disa misionarë që po shkonin në Indonezi të cilët nuk mund t'i merrnin me vete fëmijët e tyre sepse atje nuk kishte shkolla për ta. Kështu që Hardi (djali) dhe Pak dhe Hans (dy vajzat) erdhën për të jetuar me familjen Ten Bum. Ayre i pëlqente shumë të rrinin në B.J. – emri që i vunë shtëpisë së Ten Bum-ëve. Nuk ishin vetëm ata. Vajza të tjera erdhën për të jetuar në familjen Ten Bum gjithashtu. Shpejt shtëpia ishte plot. Ishte një familje e madhe e lumtur!

Piktura 3-4

Betsi gatante dhe kujdesej për rrobat. Kur ajo qepte një fustan për njëren nga vajzat, ajo u shkruante një letër prindërve të saj

dhe përfshinte aty një copë nga materiali – që ata ta shihnin se si ishte.

Misionarët nuk mund të paguanin për dhomat dhe mbajtjen e fëmijëve. Familja i besoi Zotit Jezus që të kujdesej për nevojat. Nëse kishin nevojë për rroba të reja ose këpucë të reja, ata luteshin për to. Dhe Zoti i plotësonte nevojat e tyre. Për shembull, kur Korit i erdhi lajmi se kishte shitur një orë të kushtueshme, u gëzuan të gjithë.

“Tani do të kem fustanin tim të ri!” bërtiti njëra prej tyre.

“Dhe unë do të kem këpucët e reja,” Bërtiti tjetri.

Gjyshi ishte shumë krenar për fëmijët në shtëpinë e tij. “Ata janë kaq të ëmbël dhe të bindur,” i tha ai një mbrëmje një vizitori. “Ata nuk grinden kurrë.”

Kori buzëqeshi. “Oh, baba, dashuria është e verbër!” tha ajo me vete. Ajo sapo e kishte dërguar Pak-ën lart sepse kishte thënë “E urrej Tinin!” Tini ishte njëra nga vajzat e tjera që rrinin në shtëpi.

Më vonë atë mbrëmje Kori shkoi lart për të biseduar me Pak-ën.

“Pak, a e di se është shumë keq që të urresh dikë? Është e njëjta gjë si vrasja. Zoti Jezus na thotë se duhet t’i duam armiqtë tanë.”

“Por nuk mund ta dua Tinin.”

“Nëse i përket Zotit Jezus, dashuria e Tij është në zemrën tënde. Me dashurinë e Tij mund ta duash Tinin. Pse nuk e lë Zotin të të ndihmojë që ta duash Tinin?”

Ato u lutën së bashku. Pak i tha Zotit se i vinte keq për urrejtjen që kishte pasur ndaj Tinit. Ajo i kërkoi Zotit që ta falte dhe ta ndihmonte që ta donte Tinin. Pas kësaj Pak dhe Tini u bënë shoqe. Shumë vite më vonë, kur Pak ishte në Indonezi, atë e kishin futur në një kamp burgimi japonez. Rojet ishin shumë mizorë. Ishte shumë e vështirë të doje njerëz të tillë. Ajo patjetër kishte nevojë që Zoti ta ndihmonte. Ishte një gjë e mirë që Pak e kishte mësuar tashmë në shkollën e Perëndisë në B.J. A i urren të tjerët? A ke mësuar të duash dhe të falësh?

Piktura 3-5

Deri tani mund ta kuptoni se askush nuk mund të mërzitej në një shtëpi me një person si Kori. Kori kishte themeluar Klubin e Vajzave të Haarlemit. Atje kishte gjithfarë gjërash për të bërë, si muzikë, punëdore dhe gjimnastikë. Por në çfarëdo grupi të ishin vajzat, ato dëgjonin për Zotin Jezus. Shumë vajza nuk vinin në klub për të dëgjuar për Zotin Jezus, por për kënaqësinë e tyre.

Njëra nga ato ishte Ani, që u bë pjesë e grupeve të këngës, të anglishtes dhe të gjimnastikës. Kori ishte gjithashtu edhe në grupin e gjimnastikës, por jo sepse kishte prirje për këtë. Ndonjëherë ajo nuk dilte dot më nga unazat

lëkundëse dhe vajzave i duhej ta ndihmonin të dilte.

Në mes të orëve të klubit, ajo i frynte një bilbili. Të gjitha vajzat vinin dhe uleshin rrotull saj. Pastaj Kori u tregonte atyre diçka për Zotin Jezus. Pas kësaj, ora e gjimnastikës vazhdonte, si më parë. Këtu Ani dëgjoji për Zotin Jezus për herë të parë.

Një ditë ajo ishte shumë e zemëruar me mësuesin e gjimnastikës. Si ndëshkim ajo i shqepi këmbët e pantallonave të tij dhe hodhi ujë në këpucët e tij. Kori ishte kaq e zemëruar sa i tha Anit të mos vinte në klub për tre javë. Sidoqoftë javën tjetër ajo u kthye përsëri. Kori nuk tha asgjë.

Gjatë verës ata kishin kampe për vajza. Fëmijët nga B.J. (shtëpia e familjes) shkonin për të ndihmuar. Në këtë mënyrë ata bënë edhe një pushim. Ata mësuan kaq shumë në kampe, kështu që më vonë ata filluan klubet e tyre. Sigurisht që vajzat kënaqeshin në kampe. Ndonjëherë vajzat nuk silleshin mirë. Një vajzë ecte në gjumë. Kori ishte shumë e shqetësuar për këtë dhe çdo herë ajo e sillte atë me kujdes në shtrat. Një mëngjes, doli që, vajza që ecte në gjumë na kishte edhe një oreks shumë të mirë, sepse atë natë i kishte ngrënë të gjitha çokollatat.

Piktura 3-6

Në mbrëmje, rreth zjarrit të kampit, të gjithë ishin seriozë. Ata këndonin së bashku dhe flisnin për Perëndinë. Edhe Ani, vajza për të cilën sapo fola, ishte në njërin prej atyre kampeve. Ajo ishte shumë e trishtuar dhe e mërzhitur, sepse sapo ishte ndarë nga i dashuri i saj.

Një mbrëmje të errët, ndërsa ishin ulur nën dritën e flakëve, Kori tha, “Kur je në telashe dhe nuk e di përgjigjen, tregoi Zotit për këtë. Ai e ka në dorë të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen tënde në duart e Tij.”

Pikërisht atëherë dhe aty Ani e besoi Jezus Krishtin si Zotin dhe Shpëtimtarin e saj. Pas kësaj kur ishte e trishtuar, ajo gjithashtu mendonte për atë që Kori kishte thënë dhe kjo e ndihmonte. A ndihesh ndonjëherë i trishtuar? Mbjaj mend, nëse i ke besuar Zotit Jezus, Ai ka të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen tënde në duart e Tij.

Në vitin 1939 filloi Lufta e Dytë Botërore. Edhe Holanda u përfshi në Luftë. Më vonë, klubet si ato që kishte Kori nuk ishin më të lejuara. Në mënyrë sekrete, Kori takohej me disa vajza edhe një herë tjetër. Ndërsa po këndonin himnin kombëtar (“Wilhelmus”), vajzat filluan të qanin.

“Vajza, ne nuk duhet të qajmë,” tha Kori. “Jemi kënaqur por ajo që është më e rëndësishme kemi dëgjuar për Zotin Jezus. Ai ka të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen tonë në duart e Tij, edhe në kohë të pasigurta, si kjo luftë.”

Ishte një kohë shumë e vështirë për Korin dhe vajzat, por ato mësuan shumë mësimë në shkollën e Perëndisë.

Perëndia e di se ka disa mësimë të rëndësishme për jetën të cilat ne mund t'i mësojmë vetëm duke kaluar nëpër sprova dhe vështirësi. Në kohë të tilla ne mësojmë t'i besojmë Atij më shumë dhe t'i bindemi vullnetit të Tij. A ke qenë duke kaluar kohë të vështira kohët e fundit. A po e mëson mësimin e rëndësishëm që Perëndia dëshiron të të mësojë në shkollën e Tij? Dëgjoje Fjalën e Perëndisë! Bëj atë që thotë ajo! Beso tërësisht në Zotin!

Pyetjet e përsëritjes

- 1 Pse duhet të shkojnë në shkollë djemtë dhe vajzat? (Për të mësuar gjërat që kanë nevojë në jetë si, të lexuarit, matematika dhe gjeografia.)
- 2 Kush është në shkollën e Perëndisë? (Kushdo që po beson në Zotin Jezus Krisht.)
- 3 Çfarë mësoi Kori në shkollën e Perëndisë, kur ishte e sëmurë në shtrat për një kohë të gjatë? (Të pranonte faktin që ishte e sëmurë, pa e ditur pse dhe t'i thoshte “faleminderit” Zotit në të gjitha rrethanat.)
- 4 Çfarë zbuloi Kori kur i dha mësim nga Bibla fëmijëve me aftësi të kufizuara në të mësuarit? (Që ata ishin në gjendje të mbanin mend mësimet biblike dhe të donin Zotin Jezus)
- 5 Kush erdhi për të jetuar në shtëpinë e Ten Bum-ëve, kur atje jetonin vetëm babai, Betsi dhe Kori? (Fëmijë që nuk mund të qëndronin me familjet e tyre.)
- 6 Çfarë mësoi Pak – vajza që e urrente Tinin – në shkollën e Perëndisë? (Të donte armiqtë e saj.)
- 7 Pse e themeloi Kori Klubin e Vajzave të Haarlemit? (Që t'u jepte vajzave një mundësi për të dëgjuar për Zotin Jezus)
- 8 Pse na lejon Perëndia që të kalojmë nëpër sfida dhe vështirësi? (Në ato kohë ne mësojmë që t'i besojmë Atij më shumë dhe t'i bindemi vullnetit të Tij)

Mësimi 4

Jezusi është Fitimtar

Qëllimi: Të kuptojmë që Zoti është me fëmijët e Tij, nuk ka rëndësi se ku shkojmë ne.

Romakëve 8:38-39 - “Sepse unë jam i bindur se as vdekja, as jeta, as engjëjt, as pushtetet... as ndonjë tjetër krijesë, nuk do të mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë që është në Jezus Krishtin, Zotin tonë.”

Mësimi

Piktura 4-1

Kori dhe babai i saj po ecnin në rrugë. Papritur Z. Ten Bum e drejtoi Korin në një dritare të një dyqani. Ata panë shënimin e vogël brenda dritares dhe lotët i rrodhën nga sytë. Shënimi thoshte: “Nuk i shesim hebrejve.” (Hebrenjtë janë pasardhësit e Abrahamit – populli që Perëndia zgjodhi për një detyrë të veçantë).

“Oh, Kori,” tha babai. “Sa e tmerrshme është kjo dhe po ndodh madje edhe këtu në Haarlem!”

Kudo në Haarlem dhe gjithashtu edhe në pjesën tjetër të Hollandës mund të shihje shënime të tilla. Hebrenjtë nuk u lejohej më të udhëtonin në tramvaj, të shkonin në teatër, të vizitonin parqe. Hebrenjtë duhet të mbanin një yll të madh të verdhë në palltot e tyre në të cilën ishte shkruar fjala “Hebre”, që të gjithë ta kuptonin se kush ishte hebre.

Si mund të ndodhë kjo gjë? Në gjermani erdhi në pushtet një njeri i ligë, Adolf Hitler. Ai i fliste popullit gjerman për pushtimin e të gjithë Evropës me ushtarë - Austrisë, Polonisë, Danimarkës, Norvegjisë dhe shumë vendeve të tjera, duke përfshirë edhe Hollandën, ku jetonin Kori dhe familja e saj. Nazistët, siç quheshin ndjekësit e Hitlerit, bënë shumë gabime. Më i keqi nga të gjithë ishte masakrimi i popullit të zgjedhur të Perëndisë, Hebrenjtë.

Familja Ten Bum i donte shumë hebrejve. Ata kishin lexuar për këtë popull në Bibël. Vetë Zoti Jezus kishte lindur në një familje hebreje. Perëndia e kishte vendosur dashurinë për popullin e Tij në familjen Ten Bum.

Pak më vonë, ata panë me lot ndër sy se si një grup ushtarësh gjermanë që bërtisnin, detyronin disa njerëz që të hipnin në një makinë policie. A ishin këta njerëz kriminelë? Jo, kjo ndodhte vetëm sepse ata ishin hebrej. Më vonë këta njerëz do të çoheshin në kampe në gjermani dhe Poloni dhe do të vriteshin atje.

“Kori,” tha babai. “Kam frikë se Perëndia do t’i ndëshkojë ata njerëz për atë që kanë bërë. Ata kanë prekur beben e syrit të Perëndisë.”

Bebja e syrit tënd, është pjesa më delikate e trupit tënd. Nëse dikush e prek atë të dhemb shumë.

Kori u lut, “Zot, dua të bëj ç’të mundem për të shpëtuar popullin tënd.”

Piktura 4-2

Diçka shumë e çuditshme po ndodhte. Shumë njerëz po vizitonin shtëpinë e Ten Bum-ëve (B.J.). Dukej sikur të gjithë duhet të rregullonin orët e tyre tek Ten Bum’-ët. Mund të shikonit shumë adoleshentë duke shkuar atje. A kishin aq para sa të blinin një orë? Kori qëndroi pas banakut. Burri që kishte radhën nxori nga xhepi i tij një orë për gra.

“Gruaja ime dëshiron të dijë nëse mund të riparohet kjo orë. Gjithmonë ndalon.”

Ky ishte një kod i veçantë. Mesazhi donte të thoshte se ai ishte një hebre që kishte nevojë të shpëtonte.

Bam! U përplas dera e dyqanit. Klienti i mëparshëm ishte larguar. Tani kishin mbetur të dy vetëm në dyqan.

“Është një grua e re,” pëshpëriti ai.

“Kemi një vend në Groningen,” pëshpëriti edhe Kori. “Thuaji që të bëhet gati në kopshtin e shtëpisë.”

Ata pëshpëritën të dy dhe ranë dakord se çfarë duhet të bënte kjo grua. Pastaj ulën kokat dhe Kori u lut, “Zoti Jezus, bekoje këtë plan për të shpëtuar këtë grua të popullit Tënd. Amen.”

Kur burri iku, ai e futi orën përsëri në xhep.

Më vonë ra zilja e telefonit. Personi tha, “Dërgoje orën e atij burri në fabrikë. Mund të rregullohet atje.”

A e dini se çfarë donte të thoshte kjo? Donte të thoshte: kemi gjetur një adresë ku mund të fshihet një hebre.

Tani ju e kuptoni pse disa njerëz vini në shtëpinë e Ten Bum-ëve (B.J.). Shumë burra e gra dhe madje edhe adoleshentë, ndihmonin Korin për të fshehur hebrenjtë në shtëpitë e njerëzve të tjerë. Për arsye se kjo duhet të bëhej në fshehtësi, u quajt “puna për nëntokësorët.” Kori i quante të gjithë njerëzit që e ndihmonin atë “Nëntokësorët e Perëndisë.” Ata e bënë këtë sepse e donin shumë Zotin Jezus dhe popullin e Tij.

Piktura 4-3

“Darka është gati!” thirri Betsi.

Tavolina u shtrua për nëntë veta. Ata vinin prej ngado - Kori nga dyqani, babai nga punishtja dhe gjashtë njerëz që jetonin

në shtëpinë e tyre në mënyrë të sekrete. Ata njerëz quheshin “njerëz të fshehur.” Tre prej tyre ishin djem që nuk donin të merreshin nga policia sekrete për të punuar në Gjermani në një fabrikë lufte dhe tre nga njerëzit ishin “orë” (hebrenj) – dy gra, Meri dhe Tea dhe një burrë, Eusi.

Ata po bisedonin gëzueshëm me njëri tjetrin ndërsa po hanin. Herë pas here shpërthenin në të qeshura për shkak të shakave të Eusit. Pastaj papritur ...

“Bazz” – u dëgjua tingulli i një zileje nëpër shtëpi. Kjo donte të thoshte rrezik. Të gjithë kërcyen nga vendi. “Njerëzit e fshehur” rrëmbyen gjërat e tyre dhe vrapuan lart për në dhomë ne Korit. Në murin e dhomës së saj ishte një hapje për në një dhomë sekrete. Ajo dhomë e vogël ishte gati një metër e gjerë. Ata u ulën e atje duke mbajtur qetësi, me zemrat që i rrihnin fort. Nuk guxonin as të kolliteshin apo të teshtinin.

“A po vini prapë poshtë?” thirri një zë pas disa minutash.

Fatmirësisht ishte zëri i Korit. Nuk ishte bastisje nga Gestapo, siç quhej policia sekrete. Ishte vetëm një alarm. Kori ndihmoi Merin të dilte nga hapja në mur. Eusi ia filloi nga shakatë përsëri.

“Po mendoja se kishte kohë që nuk kemi ngrënë tortat me krem!”

“Shpresoj që kurrë të mos ndodhë vërtetë,” psherëtiu Tea.

Po, kjo ishte arsye pse bëheshin këto alarme. Nëse Gestapo do të bastiste shtëpinë të gjithë duhet të fshiheshin sa më shpejt të ishte e mundur. Shtëpia dukej sikur aty jetonte vetëm një plak me dy vajzat e tij të pamartuara. Për shkak se këto alarme nuk ishin aspak të këndshme dhe ndodhnin në momentet më të çuditshme, Betsi u jepte atyre tortë me krem pas çdo alarmi.

“Urime!” tha Kori me gëzim ndërsa mbante kronometrën në dorë, “E keni thyer rekordin tuaj. Dhjetë sekonda më shpejt se herën e fundit.”

Ende duke psherëtirë dhe duke u dridhur pak, ata

vazhduan të hanin. Pas ushqimit babai mori Biblën.

“Sot do të lexojmë Psalmën 91,” tha ai. “Kush banon në strehën e Shumë të Lartit, pushon në hijen e të Plotfuqishmit ... Sepse Ai do të urdhëroi Engjëjt e Tij të të ruajnë në të gjitha rrugët e tua” (vargjet 1 dhe 11).

“Faleminderit, Zoti Jezus, që Ti je vendi ynë i fshehtë i vërtetë,” u lut Kori në zemrën e saj.

Eusi mendoi për një moment për gruan e tij dhe beben që ishin fshehur diku tjetër. Ai nuk e dinte ku. Kishte engjëj rreth shtëpisë B.J. (shtëpisë së Ten Bum-ëve). Ai u lut që Perëndia të vendoste engjëj rreth gruas dhe fëmijës të tij gjithashtu.

Lexojeni vetë vargun nga Bibla juaj, ose ta lexojë një fëmijë më i rritur.

Edhe një herë tjetër zilja tingëlloi përsëri nëpër shtëpi. Por kësaj here nuk ishte një alarm provë. Dikush kishte zbuluar se Kori kishte fshehur hebrenj në shtëpi dhe ia kishte treguar këtë Gestapos. Të gjashtë “njerëzit e fshehur” arritën të hynin në kohë në dhomën sekrete. Iu desh të qëndronin aty për gjashtë ditë. Policia hollandeze e bëri të mundur që ata të shpëtonin dhe të merreshin në vende të tjera të fshehta. Të gjithë të tjerët në shtëpi në atë kohë u arrestuan – duke përfshirë edhe Ten Bumët. Gestapo kërkoi të gjithë vendin për të gjetur dhomën sekrete, por nuk e gjeti. Të gjithë u çuan në rajonin e policisë dhe ditën tjetër në burgun Scheveningen.

Dhjetë ditë pas arrestimit, Z. Ten Bum vdiq. Ai shkoi të jetonte me Zoti Jezus në Qiell. Askush nuk njeh dhimbje të Qiell. Atje do të gjesh njerëzit që besuan në Zotin Jezus dhe që besuan se Ai u ndëshkua në kryq për gjërat e këqija që ata kishin bërë. Z. Ten Bum besonte në Zotin Jezus. Ai e donte kaq shumë Shpëtimtarin sa fliste për të me këdo. Për Z. Ten Bum ishte një nder që të shpëtonte hebrenjtë nga dora e Gestapos. Perëndia gjithashtu e lejoi atë të vuante për hir të popullit të Tij të hebrenjve, beben e syrit të Perëndisë.

Është një nder për ty dhe mua kur Perëndia na zgjedh të vuajmë për hir të Krishtit. Për shembull, kur i tregon të tjerëve në shkollë se je i krishterë dhe ata tallen me ty. Ose, kur shkon të dielën në kishë në vend që të shkosh për të luajtur me skuadrën tënde të futbollit dhe trajneri mërzhitet.

Mund të mos na pëlqejë vuajtja, por Perëndia e lejon atë në jetët tona që të na ndihmojë të bëhemi më shumë si Zoti Jezus. Na trishton për momentin, por kur të shkojmë në Qiell do të kuptojmë që ajo pak vuajtje që kishim në tokë është kaq e vogël krahasuar me lavdinë e të qenit me Jezusin.

Piktura 4-4

Gati të gjithë ata që ishin arrestuar u liruan pas dy muajsh, përveç Betsit dhe Korit. Nëse Zoti Jezus nuk do të kishte qenë me to, nuk e di se si do t’ia kishin dalë mbanë, sepse bashkë me mijëra gra të tjera ishin ngjeshur nëpër vagonë kafshësh dhe ishin çuar në Gjermani.

Pas një udhëtimi të tmerrshëm prej disa ditësh ato arritën në kampin e burgut të grave në Ravensbrück. Kishin pasur mundësi të merrnin vetëm pak gjëra nga Holanda, por ato gjëra ishin shumë të rëndësishme për to – një shall të blu prej leshi që e kishte veshur Betsi sepse ishte shumë e sëmure, një shishe me lëng vitaminash dhe më e çmuara, një Bibël e vogël.

Megjithatë, kur hynë në ndërtesën ku ato duhet të regjistroheshin, ato panë me dëshpërim se duhet të dorëzonin gjithçka, literalisht gjithçka. Po shihja e tyre e vitaminave, shalli prej leshi dhe Bibla e tyre?

“Oh, Zoti Jezus,” u lut Kori butësisht, “kemi kaq shumë nevojë për Fjalën Tënde në këto ambiente të tmerrshme, për veten tonë dhe për të gjitha ato gra të tjera. Na ndihmo që ta mbajmë atë.”

Fytyra Betsit u shtrembërua nga dhembja.

“Kori, kam vërtetë nevojë të shkojë në banjë.”

“Zotëri,” pyeti Kori rojën, me aq mirësjellje sa mundej. “Motra ime nuk mund ta mbajë më.”

Burri nuk tha as edhe një fjalë, por tregoi tek një derë. Kori hapi derën por nuk pa banjë.

“A mund të më thoni se ku janë banjat, Zotëri?” pyeti një roje tjetër. “Përdor kanalën!” i bërtiti ai asaj dhe mbylli derën pas tyre.

Tani të dyja ishin në një dhomë dushi, vetëm ato të dyja. Papritur Kori e kuptoi se ata do të ktheheshin më vonë këtu bashkë me të paktën njëqind gra të tjera, për të bërë një dush dhe për të veshur rrobat e burgut të cilat ishin tashmë duke pritur në një grumbull.

“Betsi,” pëshpëriti ajo. “Hiqe shpejt shallin tënd! Shpejt!”

Kori i mbështolli me shpejtësi shishen e vitaminave dhe Biblën me shallin dhe i fshehu nën grumbullin me rroba. Pastaj të dyja u kthyen në dhomë për t’u regjistruar.

Perëndia nuk të lë kurrë vetëm. Më vonë, Kori dhe Betsi e lanë dhomën e dushit, duke veshur secila vetëm një fustan të hollë dhe një palë këpucë. Megjithatë Kori kishte një gungë të vogël në kurriz: ato ishin Bibla dhe shishja e vitaminave në një çantë të vogël që varej nga qafa e saj. Ajo gjithashtu kishte edhe një gungë rreth mesit të saj: ishte shalli blu i Betsit. Të gjitha gratë kontrolloheshin tre herë që të ishte e sigurt që nuk kishin marrë gjë me vete fshehurazi. Betsi u kontrollua por Kori nuk u kontrollua.

Ndoshta Kori mendonte për kohën kur ishte vajzë e vogël dhe i thoshte babait të saj, “Babi, kam shumë frikë se mos të gjithë ju vdisni.”

“Kori,” i kishte thënë babai në atë kohë, “kur të duhet të shkosh diku me tren, kur t’i kam dhënë paratë për biletën?”

“Pikërisht para se të largohem,” ishte përgjigjur Kori.

“Kori,” tha pastaj babai, “nëse Ati ynë Qiellor lejon që të na ndodhin gjëra të këqija, Ai do na japë forcën për t’i përballuar ato në atë moment. Por përderisa nuk ka ndodhur, nuk duhet të kemi frikë.”

Në kampin e tmerrshëm Zoti Jezus i ndihmoi ato të përballonin shumë prova të mëdha dhe të vështira. Ai, madje, i lejojë ato të shihnin mrekulli. Tashmë e kishin përjetuar një mrekulli (kur rojet nuk ia morën Biblën, shallin dhe vitaminat) por gjëra të tjera po vinin.

Piktura 4-5

“Kazerma 28” ishte kazerma ku Kori dhe Betsi u futën bashkë me të paktën 1,400 gra të tjera. Ishte kazerma më e pisët që mund të imagjinoni. Kur arritën atje për herë të parë vunë re që vendi gëlonte nga pleshtat. Për një moment, Kori mendoi për shtëpinë e tyre, B.J., ku Betsi e mbante çdo gjë kaq të rregullt dhe të pastër.

Kori foli: “Betsi, nuk mund t’i durojmë gjithë këto insekte të pista!”

Kështu që Betsi u lut, “Zot, na trego se çfarë duhet të bëjmë.” Pastaj ajo e kuptoi. “Kori, e mban mend se çfarë kemi lexuar këtë mëngjes? ‘Për çdo gjë falënderoni.’ Duhet të falënderojmë Zotin për pleshtat.”

“Betsi, dua të falënderoj Perëndinë për çdo gjë, por jo për pleshtat.”

“Kori, në Bibël është shkruar, ‘Për çdo gjë falënderoni.’ Kjo nuk është vetëm për gjërat e mira, por gjithashtu edhe për ato që nuk janë shumë të mira.”

Pastaj ato falënderuan Perëndinë së bashku, që ato mund të rrinin të dyja dhe që mund t’ia tregonin ungjillin kaq shumë grave. Betsi e falënderoi Perëndinë madje edhe për pleshtat. Sidoqoftë, Kori nuk ishte dakord me Betsin për të falënderuar për pleshtat.

Nëse je i krishterë, a ke mësuar të falënderosh në çdo situatë? Është e mrekullueshme që Zoti është me ne gjatë gjithë kohës. Bibla thotë që “të gjitha gjëra bashkëveprojnë për të mirë” (Romakëve 8:28) – edhe gjërat më të vështira. Prandaj mund të falënderojmë në çdo situatë.

Një natë ishin ulur në qoshe të kazermës nën një llambë të vogël të vetmen që ishte e ndezur. Kori lexonte nga Bibla. Rreth tyre kishte gra. Gjithë ditën kishin punuar si skllëvër dhe ishin përndjekur nga roje femra. Ato dëgjonin me vëmendje, ndërsa Kori lexonte nga Bibla.

“Kush do të na ndajë nga dashuria e Krishtit? Pikëllimi, a ngushtica, a përndjekja, a uria, a të zhveshurit, a rreziku, a shpata?” (Romakëve 8:35.)

Dukej sikur ato fjalë ishin shkruar veçanërisht për Ravensbrück. Gratë i përjetonin çdo ditë gjërat që Kori u kishte lexuar atyre.

Kori vazhdoi të lexonte. “Por në të gjitha këto gjëra ne jemi më shumë se fitimtarë për hir të atij që na deshi. Sepse unë jam i bindur se as vdekja, as jeta ... as ndonjë tjetër krijesë, nuk do të mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë që është në Jezus Krishtin, Zotin tonë” (Romakëve 8:37-39).

Fytyrat e grave u ndriçuan nga gëzimi. Në mes të të gjithë mizorisë ato përjetuan një copëz Qiell. Ngadalë gratë filluan të këndonin, shumë ngadalë – sepse po t’i dëgjonte ndonjë roje, do të vinte për të parë se çfarë po ndodhte dhe do të kishte probleme! Në këtë kamp rojet e quanin Biblën një libër gënjeshtresh. Çdo i burgosur që kapej me një Bibël

Shihni 1 Thesalonikasve 5:18.

Lexojeni vetë vargun nga Bibla juaj, ose ta lexojë një fëmijë më i rritur.

Lexojeni vetë vargun nga Bibla juaj, ose ta lexojë një fëmijë më i rritur.

dënohej rëndë. Dukej e çuditshme që asnjë roje femër nuk kishte hyrë kurrë në fjetore, kur zakonisht ishin në të gjithë vendin. Një herë, për një arsye, një e burgosur donte të merrte një roje, por roja refuzoi të vinte tek Kazerma 28.

“Kazerma 28!” tha ajo me vetulla të vrenjtura, “Nuk shkoj atje; vendi gëlon nga pleshtat!”

Prandaj ishin në gjendje të lexonin Biblën dhe të flisnin kaq lirshëm. Tani edhe Kori mund të falënderonte Perëndinë për pleshtat.

Piktura 4-6

Një natë Betsi zgjoi Korin.

“Pse nuk më lë të fle? Ti e di se sa e lodhur jam!” mermëriti Kori. U bezdis shumë.

“Jo, Kori, Perëndia më ka treguar diçka që duhet të ta tregoj menjëherë, përndryshe do ta harroj.”

Kori kërkoi falje për atë që kishte thënë. Ato e futën kokën nën pallton që e përdornin si batanije dhe Betsi filloi të fliste.

“Kori, ky kamp është bërë që të shkatërrojë njerëz. Pas luftës duhet të marrim një kamp të tillë ta rinovojmë tërësisht me ngjyra të bukura dhe shumë lule. Më pas mund të përdoret nga njerëz që kanë humbur shtëpinë e tyre gjatë luftës. Ka një shtëpi shumë të bukur në Hollandë. Duhet ta përdorim atë shtëpi për të strehuar njerëz që kanë vuajtur kaq shumë në kampet e përqendrimit, në mënyrë që mendjet dhe zemrat e tyre të mund të shërohen prej atyre gjërave të tmerrshme që kanë përjetuar.”

“Dhe a do të jetojmë edhe ne në atë shtëpi?” pyeti Kori. Do të ishte e mrekullueshme të jetoje në një shtëpi të bukur me një kopesh plot me lule, pas jetës në këtë kamp përqendrimi të pisët dhe të zymtë.

“Vetëm për një kohë të shkurtër, Kori. Pastaj duhet të shkojmë në të gjithë botën për t’i treguar njerëzve kudo, që sado e madhe të jetë mizoria, Zoti Jezus Krisht është gjithmonë më i madh. Ata do të na besojnë ne, sepse e kemi përjetuar vetë.”

Kori dëshironte të fliste më shumë, por Betsin e kishte zënë gjumi tashmë.

Betsi nuk jetoi kurrë në atë shtëpi të bukur. Ajo vdiq pak ditë më vonë. Zoti Jezus e mori atë në një shtëpi edhe më të bukur, në shtëpinë e Atit të Tij në Qiell.

Dhe Kori? Dikush në kampin e përqendrimit bëri një gabim. Aksidentalisht ai liroi një grua që nuk duhej të ishte liruar fare. Por kur e kuptuan, ajo grua kishte shkuar tashmë në Haarlem. Gruaja ishte ... Kori. Nëse do të kishte qëndruar në kamp, do të kishte vdekur. Por Perëndia nuk donte që ajo të vdiste. Perëndia donte që Kori të bënte atë që Ai i kishte treguar Betsit. Vullneti i Perëndisë duhej të bëhej. Çfarë kohe e vështirë ishte për Korin dhe Betsin në atë kamp përqendrimi.

Lexojeni vetë vargun nga
Bibla juaj, ose ta lexojë
një fëmijë më i rritur.

E megjithatë, Zoti ishte me ato dhe kjo ndryshonte gjithçka. A nuk është e mrekullueshme që të dish që Zoti premton që të jetë me fëmijët e Tij, kudo ku të jenë ata? Ai ka thënë, “Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët” (Mateu 28:20). Asgjë nuk do të mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë.

Pyetjet e përsëritjes

- 1 Cila ishte gjëja më e keqe që bënë nazistët? (Ata masakruan popullin e Perëndisë, hebrenjtë).
- 2 Cilit popull i përkiste Zoti Jezus? (Popullit të hebrenjve.)
- 3 Si i ndihmuan hebrenjtë Kori dhe familja e saj? (Ata i fshehën hebrenjtë në shtëpinë e tyre dhe në shtëpi të tjera për t'i shpëtuar nga nazistët).
- 4 Çfarë duhet të bënin “njerëzit e fshehur” kur dëgjohej tingulli i një zileje nëpër shtëpi? (Të fshiheshin sa më shpejt të ishte e mundur në dhomën sekrete).
- 5 A e dini arsyen kryesore pse armiku nuk e gjeti dhomën sekrete, kur e kontrolluan të gjithë vendin? (Zoti Jezus po mbronte “njerëzit e fshehur”).
- 6 Pse i lejon Perëndia vuajtjet në jetët tona? (Për të na bërë më shumë si Zoti Jezus).
- 7 Çfarë mrekullish bëri Zoti, kur Kori dhe Betsi hynë në kampin e burgut? (Ai e bëri të mundur që Kori të merrte me vete Biblën e saj, shallin dhe shishen me vitamina).
- 8 Si u liruan nga kampi i burgut Betsi dhe Kori? (Perëndia e mori Betsin në Qiell dhe e liroi Korin nëpërmjet “gabimit” të dikujt).

Mësimi 5

Një endacake për Zotin

Qëllimi: T'i mësojmë fëmijëve se sa e rëndësishme është që të ndjekin udhëheqjen e Perëndisë.

Mateu 28:19-20 - “Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt ... ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës.”

Mësimi

Piktura 5-1

“Zonjushë, a mund të më japësh një biletë për qytetet - Hong Kong, Sidnej, Aukland, dhe prapë kthim në Sidnej. Nga atje drejt e në Kejptaun, pastaj në Tel Aviv dhe në fund në Amsterdam?”

Vajza në agjencinë e udhëtimit në Tajvan pa me habi gruan e moshuar përballë saj, që sapo kishte porositur biletat për të shkuar në të gjitha këto qytete. Mos ndoshta donte të vizitonte nipërit e mbesat e saj?

“A mund të ma tregoni destinacionin tuaj final?” pyeti vajza me mirësjellje. “Destinacioni im final është Qielli,” u përgjigji gruaja e moshuar.

“Më falni, zonjë, a mund të ma gërmëzoni ju lutem?”

“Q.I.E.L.L.I.,” gërmëzoi ngadalë gruaja e moshuar.

Kur vajza e kuptoi se çfarë kishte shkruar ajo filloi të buzëqeshte.

“Por nuk e kisha fjalën për këtë,” tha ajo.

“Unë po,” i buzëqeshi edhe gruaja e moshuar. “Por nuk duhet ta shkruash; tashmë e kam një biletë për në Qiell.”

“Një biletë për në Qiell?” Vajza ishte shumë kureshtarë tashmë.

Gruaja e moshuar e pa këtë dhe ishte gati të shpjegonte atë që po thoshte. “Rreth dymijë vjet më parë Dikush e pagoi çmimin për mua që unë të shkoj në Qiell. Emri i Tij është Jezus dhe Ai pagoi kur vdiq për mëkatet e mia.”

“Ajo grua ka të drejtë,” e ndërpreu një zë burri. Ishte një nëpunës zyrtar kinez që sapo kishte hyrë në agjencinë e udhëtimit.

Gruaja e moshuar u kthye dhe e pyeti, “A ke një biletë për në Qiell?”

“Po, kam,” qeshi ai. “Kur isha fëmijë dhe jetoja në Kinë, unë pranova Jezusin si Shpëtimtarin tim prej mëkatit tim.”

“Dëgjo tani,” tha Kori (sepse ishte ajo) duke i folur vajzës që qëndronte pas tavolinës. “Sigurohu edhe ti që të kesh një biletë për në Qiell. Sepse nëse përpiqesh të hipësh në avion pa biletë, je në telashe.

Por nëse dëshiron të shkosh në Qiell pa një biletë të vlefshme, je në një telash akoma më të madh. Fol me këtë burrë për këtë. Ai e di rrugën për në Qiell.”

Kori tha u përshëndet dhe u kthye në hotelin e saj.

A je agati që të shkosh në Qiell një ditë, që të jesh me Zoti Jezus? Ka vetëm një rrugë. Duhet të kthehesh tek Krishti dhe t'i kërkesht Atij të të shpëtojë nga mëkati yt. Ai vdiq dhe u ringjall për mëkatarët, si ti dhe unë. Bibla thotë që kushdo që beson në Të do të marrë falje të mëkateve (shih Veprat 10:43). A do t'i besosh Atij që të të shpëtojë?

Ndoshta po mendon, “Si shkoi Kori deri në Tajvan? Si pati mundësi të kishte paratë e mjaftueshme për të paguar një udhëtim kaq të shtrenjtë?”

Është një histori shumë e gjatë.

Piktura 5-2

Ju e mbani mend nga hera e kaluar se si Kori dhe motra e saj Betsi ishin në kampin e tmerrshëm të burgut. Një natë Perëndia i tregoi Betsit se çfarë duhet të bënte për të ndihmuar të burgosurat e tjera. Ajo e zgjoi Korin për t'i treguar për këtë. Kur të liroheshin nga kampi dhe kur lufta të mbaronte, ato duhet të kërkonin për një shtëpi për t'u kujdesur për njerëzit që kishin vuajtur në kampe burgimi si ato.

Pas kësaj, të dyja duhet të shkonin kudo dhe t'i tregonin të tjerëve për Zotin Jezus Krisht. Sigurisht, kjo do të kushtonte shumë para, por ata nuk duhej të shqetësoheshin për këtë, sepse Perëndia ishte Ati i tyre Qiellor dhe bagëtia që ndodhej me mijëra në male ishin të Tijat (Psalmi 50:10). Kështu që nëse kishin nevojë për para, Ati i tyre Qiellor do të kishte nevojë të shiste vetëm njërën prej bagëtive. Kori gjithmonë kishte para mjaftueshëm për detyrën e saj të madhe. Të krishterët i jepnin para Korit pa ia kërkuar ajo.

Betsi mendonte se shumë shpejt do të liroheshin, kështu që tha, “Para vitit të ri të dyja do të lirohemi.”

Ajo ndodhi në një mënyrë në të cilën Betsi nuk e kishte imagjinuar. Perëndia e liroi Betsin duke e marrë atë në Qiell. Atje nuk do të ishte më e sëmurë; atje nuk do të kishte më dhembje; atje do të ishte gjithmonë me Zotin Jezus, për të cilin u kishte folur kaq shumë të tjerëve.

Kori u lirua nga kampi i burgut. Njerëzit mund të kenë menduar se ishte një aksident, por Perëndia po e udhëhiqte të gjithë këtë.

Kori shkoi në shtëpi nga Ravensbrück me një tren të zakonshëm. Rrugës ajo i bëri Perëndisë një premtim. Ajo i premtoi se jeta e saj do të ishte tërësisht e Tija, që tani e tutje. Dhe Kori, ose “Teto Kori” siç e thërrisnin shumë njerëz, e mbajti fjalën. Me ndihmën e miqve të saj ajo mori me qira një shtëpi dhe shumë shpejt, pas luftës, e gjithë shtëpia ishte e mbushur me njerëz që kishin vuajtur kaq shumë në kampet e burgimit. Ata ndihmoheshin aty për të përballuar përsëri jetën e përditshme. Kjo nuk ishte e lehtë.

A e dini se cila ishte gjëja më e vështir për t'u mësuar atje? Që të falnin njerëzit që u bënë atyre gjithë ato gjëra kaq të tmerrshme. Mendoj se për të gjithë ne është e vështirë të falim, por Zoti Jezus dëshiron të na ndihmojë. A ke mësuar të falësh të tjerët që të kanë bërë gjëra të këqija – si ai djali ose ajo vajza në shkollë që të lëndoi shumë?

Piktura 5-3

Kur kishte njerëz që mund të merrnin drejtimin e shtëpisë, Kori filloi të udhëtonte në vende të tjera për Zotin. Ajo e quajti veten një “endacake për Zotin.”

Në fillim ajo shkoi në Shtetet e Bashkuara. Ajo foli në kisha dhe u tregoi njerëzve se paraja dhe një shtëpi e bukur janë gjëra që mund t'i humbasësh. Por kurrë mos e humb Zotin Jezus, kur e ke pranuar Atë në zemrën tënde. Sado e madhe të jetë vështirësia me të cilën ti po përballesh, ti e di se Perëndia ende është duke të mbajtur në krahët e Tij të përjetshme. Ajo e kishte përjetuar këtë kur ishte në Ravensbrück. Kjo e vërtetë ishte e rëndësishme për të krishterët amerikanë. Gjithashtu është e rëndësishme për ty dhe mua.

Një herë tjetër Kori ishte në Havana, Kubë. Kjo ndodhi para se komunistët të merrnin pushtetin atje. Ajo ishte ftuar në një konvikt shkolle për vajza shumë strikt. Edhe të ftuarit duhet të mbanin ato rregulla strikte. Një mëngjes kur po hante me vajzat mëngjes, asaj i dhanë një gotë me ujë të ngrohtë.

“A duhet ta pi këtë ujë?” mendoi Kori.

Pastaj ajo e kuptoi pse kishte vetëm ujë të ngrohtë. Një bustinë me çaj po kalonte dorë më dorë dhe çdo person duhet ta mbante atë tre sekonda. Kori e mori e fundit kështu që e mbajti në gotë më gjatë. Mund ta imagjinoni se sa i butë ishte çaji – shijonte si ujë për të larë enët!

Në mbrëmje Teto Kori u lejua t'i fliste vajzave për saktësisht pesë minuta.

Ajo e pyeti drejtoreshën, “A mund të flas pak më gjatë? Dua t'i them vajzave diçka shumë të rëndësishme.”

“Jo, nuk është e mundur,” u përgjigj drejtoresha. “Vajzat kanë shumë detyra shtëpie. Nuk mund të të lejoj të flasësh më shumë se pesë minuta. Pas kësaj kanë diçka të rëndësishme për të bërë.”

Kështu që Kori vendosi të flasë për pesë minuta. Ajo tregoi për fëmijët që e kishin ndihmuar atë gjatë luftës për të fshehur bebet hebreje. Pasi kishte folur për katër minuta, papritur ikën dritat. Dhoma u zhyt në errësirë të plotë.

“Vazhdo të flasësh,” i dha drejtoresha Korit. “Gjithë sesi, vajzat nuk mund t'i bëjnë detyrat në errësirë.”

Kori vazhdoi të tregonte për udhëtimet e saj dhe për fëmijët që kishte takuar në vende të largëta. Ajo u tregoi për përjetimet e saj – si të gëzueshmet ashtu edhe të trishtueshmet.

Ajo gjithashtu u tregoi për Mikun e madh të fëmijëve, Zotin Jezus, i Cili dëshironte të jetonte në zemrat dhe në jetët e tyre.

Vajzat dëgjonin me lotë në sytë e tyre, ndërsa jashtë, burrat ishin duke u përpjekur që të rregullonin problemin me dritat sa më shpejt të ishte e mundur. Pas një ore erdhën dritat përsëri. Vajzat duhet të shkonin dhe të bënin detyrat, por një vajzë e përqafoi Korin dhe i pëshpëriti në vesh, para se të ikte, “Unë besoj se Zoti Jezus bëri që të iknin dritat, që ti të na tregojë për Të.”

Kori po udhëtonte në të gjithë botën, por ishte një vend në të cilin e kishte të vështirë të kthehej. Ishte vendi në të cilin ajo kishte qenë e burgosur – në Ravensbrück.

Piktura 1-6

E mbani mend kur Kori, si vajzë e vogël gjashtë vjeçare, ishte mbajtur fort tek parmaku sepse nuk donte të shkonte në shkollë? Çfarë bëri babai i saj? Ia hoqi gishtat një nga një dhe e çoi në shkollë. Ati i saj qiellor po i thoshte, “Kori, unë dua që të shkosh në Gjermani.”

Piktura 5-4

Gjermanët a pritën atë me shumë dashuri dhe mirësi. Ajo foli në kisha, në ish-kampet e të burgosurve që ishin rindërtuar dhe ishin bërë kampe refugjatësh, si dhe në shumë vende të tjera. Ajo foli për dashurinë e Perëndisë që është si një oqean në të cilin Ai hedh të gjitha mëkatet tona dhe pastaj Perëndia vendos një tabelë të vogël ku shkruhet “Mos Peshko”. Ajo donte të thoshte se kur Perëndia na ka falur atëherë ato gjëra nuk mund të sillen më kundër nesh.

Një herë ajo ishte ftuar të fliste në një kishë në Mynih dhe një burrë erdhi tek ajo pas shërbesës. Kori e njohu menjëherë; në fillim kishte frikë. Ky burrë kishte qenë njëri prej rojeve më mizore në Ravensbrück dhe ai po vinte drejt saj. Ajo nuk mund të bënte sikur nuk e kishte parë. Ai nuk e njohu atë; atje kishte pasur kaq shumë gra.

“Zonjusha Ten Bum,” filloi ai. “Unë kam pranuar Zotin Jezus si Shpëtimtarin tim. Ti fole për oqeanin e dashurisë së Perëndisë dhe se mëkatet e mia janë në të gjithashtu. Unë dua t’i kërkoj falje dikujt që ishte në atë kamp.” Ai i zgjati dorën, duke thënë, “A do të më falësh, zonjusha Ten Bum?”

Në fillim Kori nuk mund t’ia jepte dorën. Si mund ta falte ajo atë? Por Bibla thotë se nëse ne nuk ua falim fajet të tjerëve, atëherë as Perëndia nuk do të na falë ne.

“Zoti Jezus,” u lut ajo në zemrën e saj, “më ndihmo ta fal këtë njeri të tmerrshëm.”

Pikërisht atëherë ndodhi mrekullia. Dashuria e Zotit Jezus rrodhi nëpërmjet saj. Ajo e kapi dorën e tij të zgjatur, e takoi atë dhe tha, me të vërtetë, “Unë të fal ty vëlla.”

Pas kësaj ajo shkonte shpesh në Gjermani. Madje mezi priste që të shkonte atje.

Ti dhe unë nuk jemi rrahur nga roje burgu dhe nuk jemi lënë prej tyre të vdisnim nga uria. Ne mund t’i kërkojmë Perëndisë të na ndihmojë që të falim të tjerët që na kanë lënduar dhe madje edhe t’i duam ata që i kemi shumë zët.

Kori udhëtoi në Afrikë, Amerikë, Rusi, Indi, Kore dhe në shumë vende të tjera. Ajo shkoi në Tajvan, vendi nga ku filloi sot historia jonë.

Piktura 5-5

Kori lutej dhe i kërkonte Zotit që ta drejtonte në vendin në të cilin Ai dëshironte që ajo të shkonte. Ndonjëherë Ai e drejtonte atë tek një burg për të folur për Të. Një burg nuk është asnjëherë një vend i mirë. Megjithatë, një burg në Ruanda ishte më i keqi që ajo kishte parë ndonjëherë. Kishte kaq shumë të burgosur sa nuk mund të qëndronin të gjithë brenda. Kështu që natën gjysma e tyre flini brenda dhe gjysma jashtë.

Kur Kori shkoi atje, bashkë me një misionare, po binte shi i rrëmbyer. Të burgosurit ishin ulur jashtë, në baltë deri në gjunjët e tyre. Ata e panë Korin me fytyra të zemëruara. Kori nuk mund t’i besonte syve. Si mund t’u sillte Lajmin e Mirë këtyre burrave të varfër? Ajo nuk mund ta bënte këtë me forcat e veta, por Fryma e Shenjtë mund ta aftësonte atë për ta bërë.

Në zemrën e saj ajo u lut, “Zot, të lutem më jep një oqean prej ngazëllimit tënd për ta ndarë me këta burra të varfër.” Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së saj.

Ajo u tregoi burrave për Zotin Jezus i Cili na do aq shumë, sa kurrë nuk na braktis. Burrat ndoshta po mendonin, “Është e lehtë për të që të flasë në atë mënyrë. Ajo mund të largohet nga burgu brenda disa minutave, por ne na duhet të qëndrojmë këtu.”

Pastaj Kori u tha atyre, “Unë vetë kam qenë në një burg që ishte më i keq se ky. Nëntëdhjetë e pesë mijë gra vdiqën atje. Njëra prej tyre ishte motra ime. Por në atë ferr të tokës, ne mësuam se Jezusi kurrë nuk të braktis.”

Ndërsa po u fliste këtyre burrave, Zoti e mbushi zemrën e saj me paqe dhe ngazëllim. Por ajo nuk ishte e vetmja.

“Zoti Jezus dëshiron të vijë dhe të jetojë në zemrat tuaja dhe jetët tuaja gjithashtu. Ai thotë, ‘Unë qëndroj tek dera dhe trokas.’ Kush prej jush dëshiron që Zoti Jezus të hyjë në jetën e tij?”

Dhe më pas ... të gjithë burrat dhe rojet gjithashtu, ngritën duart e tyre. të njëjtat fytyra që ishin dukur të zemëruara në fillim, tani rrezëllenin me gëzim.

Shihni Zbulesa 3:30.

Më në fund, erdhi koha që Kori dhe misionarja të largoheshin. Kur ato po ecnin drejt makinës, të burgosurit dhe rojet i shoqëruan ato, madje edhe pas dyerve të burgut. Askush nuk mendoi që t'ia mbathte.

Ata qëndruan rreth makinës dhe në një zë thërritën, “Grua e moshuar, kthehu përsëri e na trego për Jezusin.”

Teto Kori nuk mund të kthehej, por misionarja e cila ishte me të, mund të kthehej. Që nga ajo kohë, ajo shkante atje çdo javë.

Më vonë ajo i shkroi një letër Korit ku thoshte, “Festa (bekimi) vazhdon. Çdo herë njerëz të tjerë vijnë në besim.”

Edhe të burgosurit e rinj po njihnin Shpëtimtarin.

Piktura 5-6

Për më shumë se tridhjetë vjet Kori udhëtoi nëpër botë. Ajo e quante veten “një endacake për Zotin.” Ajo gjithashtu shkroi libra, të cilat janë përkthyer në shumë gjuhë.

Më në fund Kori u plak shumë për të udhëtuar për Zotin. Perëndia i dha asaj një shtëpi në Shtetet e Bashkuara. Ajo e quajti atë “Shalom”, që do të thotë “Paqe”. Ajo jetoi atje me Pamelën, një grua që qëndroi me të gjatë viteve të saj të fundit. Korit i pëlqente kopshti i bukur, i cili ishte plot me lule të bukura në ngjyra të ndryshme të cilat ajo i pëlqente shumë.

Kori u sëmurë. Ajo u sëmur kaq shumë sa nuk mund të fliste më. Në fund të jetës së saj ajo as që mund të çohet nga shtrati i saj. Por ajo gjë të cilën ajo ende mund ta bënte ishte të donte Zotin Jezus dhe të donte të tjerët. Kur Kori ishte 91 vjeçe, ajo bëri udhëtimin e saj përfundimtar. Ishte udhëtimi për në destinacionin e saj përfundimtar, Qiellin. Ajo mund të hynte atje sepse ishte gati. Ajo e kishte “biletën e saj për në Qiell”. Zoti Jezus e kishte paguar çmimin, kur kishte vdekur në kryq për të.

A je gati për në Qiell? A e beson se Zoti Jezus e ka paguar çmimin për ty? A je gati të largohesh nga mëkatet e tua dhe t'i besosh Zotit Jezus? Bibla thotë, “Kush beson në Birin ka jetë të përjetshme” (Gjoni 3:36).

Shënim për mësuesin

Jini gati për t'ia shpjeguar rrugën e shpëtimit fëmijëve. Mund të përdorni Librin pa Fjalë ose një prezantim tjetër të thjeshtë të ungjillit. Jini të gatshëm të këshilloni fëmijët që kanë nevojë për ndihmë për mënyrën se si të vijnë tek Krishti.

Pyetjet e përsëritjes

- 1 Çfarë donte të thoshte Kori kur tha se ajo e kishte “biletën e saj për në Qiell”? (Që Zoti ia kishte falur asaj mëkatit dhe e kishte bërë gati që të shkante në Qiell)
- 2 Çfarë i tha Betsi Korit para se të vdiste në kampin e burgut? (Që ato duhet të kujdeseshin për njerëzit që kishin vuajtur në kampet e burgimit dhe se ato duhet të udhëtonin në të gjithë botën që t'u tregonin të tjerëve për Zotin Jezus)

Lexojeni vetë vargun nga Bibla juaj, ose ta lexojë një fëmijë më i rritur.

Libri pa Fjalë është prodhuar nga Bashkësia e Ungjillizimit të Fëmijëve® Nëse keni nevojë për një adresë, kontaktoni në adresën që ndodhet në fillim të këtij libri.

- 3 Si e bëri Zoti të mundur që Kori të fliste për më shumë se pesë minuta në konviktin e shkollës për vajza në Kubë? (Ikën dritat dhe dhoma u zhyt në errësirë të plotë),
- 4 Në cilin vend nuk donte të shkonte Kori? (Gjermani.)
- 5 Pse shkoi më në fund? (Zoti donte që ajo të shkonte.)
- 6 Çfarë ndodhi kur ajo takoi në Gjermani një roje të vjetër nga Ravensbrück? (Ai i kërkoi asaj që ajo ta falte dhe Zoti e ndihmoi atë që ta bënte këtë).
- 7 Çfarë ndodhi në burgun në Ruanda, kur Kori shkoi për vizitë? (Fryma e Shenjtë e ndihmoi atë t'i fliste të burgosurve dhe të gjithë të burgosurit dhe rojet besuan Zotin Jezus si Shpëtimtarin e tyre.)
- 8 Çfarë ishte gjithmonë në gjendje të bënte Kori edhe kur nuk ishte në gjendje të fliste dhe të ngrihej nga shtrati? (Ajo ishte në gjendje të donte Zotin Jezus dhe të donte të tjerët).

Kopjoje, prite dhe mbaje në Biblën tënde



Përmbledhje e hapave për këshillimin e fëmijës që dëshiron të bëhet i krishterë

Sigurohu që fëmija ka kuptuar

Perëndinë

Kush është Perëndia?
Perëndia na bëri. Ai na flet nëpërmjet Biblës.
Perëndia është i shenjtë dhe i pastër. Ai na do ne.

Mëkatin

Çfarë është mëkati?
Mëkati është mosbindje ndaj urdhërimeve të Perëndisë. Është kundër Perëndisë.
Flisni rreth mëkateve specifike.
Fëmija është mëkatar në natyrë dhe në veprim (ne mëkatojmë sepse jemi mëkatarë).
Mëkati meriton vdekjen.

Shpëtimtarin

Kush është i vetmi që mund të të heqë mëkatin?
Perëndia Bir vdiq në kryq për mëkatarët. Zoti Jezus u ringjall prej së vdekuri. Ai është Zot mbi të gjithë.

Shpjegoni se si mund të shpëtojë

Shpjegoni se çfarë dëshiron Zoti që të bëjmë ne dhe çfarë do të bëjë Ai.

Përdorni një varg biblik (*Gjoni 1:12; 3:16; 6:37; Veprat 16:31; Romakëve 6:23 or 10:13*).

Çfarë dëshiron Zoti që të bësh? Çfarë do të bëj Zoti?

Paralajmëroni për vështirësitë.

Pyesni: "A dëshiron t'i besosh Krishtit, apo do të doje të prisje?"

Inkurajojeni fëmijën që të lutet me zë (nëse është gati).

Flisni për sigurinë e shpëtimit

Kthehuni tek vargu që përdorët. Flisni për një jetë të ndryshuar.
Tregojini se çfarë mund të dijë një person që i beson vërtetë Krishtit.

Jepini (më vonë) disa udhëzime për jetën e krishterë

Lexoje dhe bindju Biblës tënde.

Flit me Perëndinë Atin tonë Qiellor.

Tregojni të tjerëve se çfarë

ka bërë Zoti për ty. Kërkoji

Perëndisë që të të falë kur

mëkaton. Takohu me të

krishterë të tjerë.

Mbaj mend premtimet e Perëndisë: "Nuk do të të lë, nuk do të të braktis" (*Heb 13:5*).